




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office



RAPORTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Mbështetja e ndërmarrjeve të vogla
dhe të mesme nga MINT/KIESA

Prishtine Maj, 2023

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare. Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 3000¹) si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditimet e performancës të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë², efikasitetit³ dhe efektivitetit⁴ dhe nëse ka vend për përmirësim.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me përmbajtjen e raportit të auditimit të performancës “Mbështetja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nga MINT/KIESA”, në konsultim me Ndhmës Auditoren e Përgjithshme, Myrvete Gashi Morina, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që realizoi këtë raport:

Ariana Gjonbalaj Shala, Drejtor i Departamentit të Auditimit

Agron Hoxha, Udhëheqës i Ekipit

Elira Hashani, Anëtare e Ekipit

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - Adresa: Lagjja Arbëria, Rr. Ahmet Krasniqi 210, Prishtinë 10000, Kosovë

Tel: +381(0) 38 60 60 04/1011

1. Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s dhe përvoja praktike
2. 2 Ekonomia - Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së burimeve. Burimet e përdorura duhet të jenë në dispozicion në kohën e duhur, në sasinë dhe cilësinë e duhur dhe në çmimin më të mirë të mundshëm.
3. Efikasiteti - Parimi i efikasitetit nënkupton marrjen e maksimumit nga burimet në dispozicion. Ka të bëjë me lidhjen mes burimeve të përfshira dhe rezultatit të dhënë në aspektin e sasisë, cilësisë dhe kohës.
4. Efektiviteti - Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritshme.

TABELA E PERMBAJTJES

Lista e shkurtesave.....	4
Përmbledhje e përgjithshme	5
1 Hyrje.....	7
2 Objektiva dhe pyetjet e auditimit	10
Pyetjet e auditimit	10
3 Gjetjet e auditimit.....	11
3.1 Mungesa e Strategjisë për Zhvillimin e NMVM-ve	13
3.2 Zonat Ekonomike.....	15
3.2.1 Mos funksionimi i këshillit kombëtar për Zona Ekonomike	15
3.2.2 Themelimi i Zonave të lira ekonomike me vendime të qeverisë pa studim të fizibilitetit	15
3.2.3 Mungesa e investimeve në Zonat Ekonomike	17
3.2.3 Mungesa e infrastrukturës në Zonat Ekonomike	21
3.3 Mungesë e analizave për nevojat e NMVM.....	24
3.3.2 Vonesa në thirrje publike	25
3.3.3 Buxheti i pa shpenzuar për shkak të vonesave në thirrje	26
3.3.4 Mangësitë në procesin e vlerësimit të aplikueseve për grante.....	27
3.4 Gjendja e bizneseve pas përfitimit.....	28
3.4.1 Monitorimi jo-adekuat i përfitueseve nga MINT/KIESA	28
3.4.2 Përkrahjet nuk kanë ndikuar në rritjen e të hyrave	32
3.4.3 Mungesa e monitorimit të vazhdueshëm nga MINT/KIESA	35
3.5 Mos koordinimi MINT/KIESA.....	36
Konkluzionet	37
Rekomandimet	38
Shtojca I Kriteret, fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	39
Motivi i Auditimit.....	39
Kriteret e Auditimit	40
Fushëveprimi i auditimit	41
Metodologjia e auditimit.....	41
Përfituesit e makinerive nga KIESA	44

Lista e shkurtesave

MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
KIESA	Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
ZE	Zonë Ekonomike
NMVM	Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme
OBZhE	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
BE	Bashkimi Evropian
EFTA	Shoqata Evropiane e Tregtisë së Lirë
CEFTA	Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore

Përmbledhje e përgjithshme

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e performancës “Mbështetja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nga MINT/KIESA”. Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), ka mandat të promovojë dhe mbështes investimet, eksportin, turizmin, NMVM-të, dhe Zonat e veçanta Ekonomike në Republikën e Kosovës. Objektivi i këtij auditimi ka qenë vlerësimi i aktiviteteve të MINT-it/KIESA-së për arritjen e rezultateve të duhura në përkrahjen dhe ngritjen e kapaciteteve të NMVM-ve dhe Zonave Ekonomike (ZE).

Subjekt i këtij auditimi ishin Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) dhe Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) lidhur me përkrahjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM). Ky auditim ka përfshirë periudhën 2019-2022.

Rezultatet tona të auditimit tregojnë se MINT/KIESA nuk ka arritur rezultatet e duhura në përkrahjen dhe ngritjen e kapaciteteve të NMVM-ve dhe Zonave Ekonomike. Thirrjet publike nuk mbështeten në analiza për nevojat e NMVM-ve, po ashtu sistemi i thirrjeve, vlerësimi dhe monitorimi përcillet me mangësi të theksuara të cilat kanë nevojë për përmirësim. Për më tepër, Zonat Ekonomike të themeluara nuk arrijnë t’i përmbushin nevojat e ndërmarrjeve në vend duke i lënë investitorët të presin me vite për zgjerimin e hapësirave të biznesit dhe rritje të prodhimit dhe të punësimit.

Mbështetja e ndërmarrjeve mikro, të vogla, dhe të mesme është bërë pa ndonjë analizë të tregut apo politika zhvillimore për përkrahjen e këtyre ndërmarrjeve nga akterët kompetent. Strategjia për zhvillimin e sektorit privat e draftuar në vitin 2017 nuk është aprovuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe nuk ishte mbështetur në analiza mbi nevojat për zhvillimin e NMVM-ve. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë kishte tentuar të zhvillonte strategjinë gjatë viti 2018, mirëpo ky proces kishte dështuar. Si rezultat i mungesave të zhvillimit të politikave për përkrahjen e ndërmarrjeve prodhuese, vendi ynë, viteve të fundit, ka shënuar rënie të investimeve në prodhim dhe rritje të investimeve në ndërtim.

Qeveria nuk ka arritur ti funksionalizojë zonat e lira Ekonomike dhe Zonë veçantë Amerikane edhe pse i kishte themeluar me vendim. Themelimi i këtyre zonave të lira ekonomike kanë kaluar pa u ndjekur procedurat sipas të cilave themelohen zonat tjera ekonomike. Këto zona janë themeluar nga Qeveria pa bërë as një analizë dhe pa studim fizibiliteti me të cilën do të argumentonin krijimin e tyre. Ndërsa këshilli kombëtar për zona ekonomike, një trup ndërministror i cili ndër të tjera kishte për detyrë që të propozojë politika dhe të hartoj planin kombëtar për zhvillimin e zonave ekonomike, nuk ka funksionuar asnjëherë. Po ashtu edhe vonesa në ndërtimin e zonave ekonomike kanë ndikuar që investitorët të kenë hapësira të kufizuara për zhvillimin e aktivitetit të tyre dhe për rrjedhojë refuzim të investimeve pikërisht për shkak të mungesës së hapësirave.

Thirrjet për mbështetjen e NMVM-ve nuk bazohen në analiza të nevojave dhe ka mangësi në procesin e vlerësimit të aplikacioneve. KIESA çdo vit përgatitë thirrje publike për mbështetjen e NMVM-ve për blerjen e makinerive për nevojat e tyre. Gjatë përgatitjes së thirrjes, KIESA nuk përshtat thirrjet në ofrimin e përkrahjes konform nevojave specifike të ndërmarrjeve, por përkrahja ofrohet vetëm për blerjen e makinerive. Po ashtu gjatë vlerësimit të aplikacioneve, një nga mostrat të cilat kemi analizuar është një ndërmarrje e madhe me mbi 1,000 punëtor e cila ka përfituar grant nga KIESA. Kjo ka ndodhur si shkak i vlerësimit jo të drejtë të aplikacioneve.

Për më tepër, vonesa në thirrje për mbështetje të NMVM ka ndikuar që buxheti i paraparë për vitin 2022 të mos shfrytëzohet për shkak të vonesave në thirrjen publike. Po ashtu edhe nga krahasimi i të dhënave për kompanitë përfituese të cilat i kemi marrë nga Administrata Tatimore e Kosovës shihet se kompanitë nuk kanë respektuar zotimet për punësim e cila ka qenë njeri nga kriteret kryesore për përfitim.

Projektet nuk monitorohen në vazhdimësi dhe nuk janë zbatuar kriteret e caktuara nga përfituesit si pasojë e mos koordinimit ndërmjet MINT dhe KIESA. Komisioni monitorues ka konstatuar parregullsi të përfituesit nga viti 2018-2021 dhe ka informuar ministrinë. Megjithatë, ka mungesë të masave të ndërmarra ndaj përfituesve që nuk i kanë plotësuar kriteret e nevojshme. Për më tepër, në MINT/KIESA mungon monitorimi i vazhdueshëm i përfitueseve dhe nuk ka informata se cila është gjendja aktuale e përfitueseve karshi kriterëve në marrëveshjet e përfitimit. Edhe pse MINT ka një departament përgjegjës për zhvillimin, koordinimin dhe monitorimin e politikave, nuk ka dëshmi të koordinimit ndërmjet MINT dhe KIESA, e cila është përgjegjëse për zbatimin e këtyre politikave.

Të gjeturat e auditimit tregojnë se çështjet që kanë të bëjnë me analizat e nevojave, vlerësim të aplikacioneve dhe monitorim të përfitueseve për Ndërmarrje Mikro, të Vogla dhe të Mesme dhe zhvillim të Zonave Ekonomike kërkojnë përmirësim. Për rregullimin e sistemit të përkrahjes së NMVM-ve dhe zhvillimin e Zonave Ekonomike është dhënë një rekomandim për Qeverinë dhe 7 rekomandime për MINT/KIESA. Lista e rekomandimeve është paraqitur në Kapitullin 5 të këtij raporti.

Përgjigja e palëve të përfshira në auditim

MINT dhe KIESA janë pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit si dhe janë zotuar se do t'i adresojnë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Hyrje


Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) luajnë një rol shumë të rëndësishëm në ekonomi, dhe në shumicën e rasteve janë titulluar si motorë të rritjes dhe zhvillimit ekonomik të një vendi. Në vitin 2019 këto ndërmarrje në Bashkimin Evropian (BE) zënë vend rreth 99.8% të të gjitha ndërmarrjeve dhe punësonin rreth 64.4% të të punësuarve në ekonominë e BE-së.⁵

NMVM-të mund të ekzistojnë në çdo industri, duke pasur një numër të vogël të punonjësve ato gjithashtu kërkojnë kapital të vogël dhe sjellje më të mëdha të inovacioneve.

NMVM-të në vendet Evropiane konsiderohen si shtylla kurrizore e ekonomisë të cilat ofrojnë punë dhe mundësi rritjeje ekonomike. Gjithashtu, pas kufizimeve të COVID-19 ato janë më të prekura nga ngadalësimi i zhvillimit ekonomik.⁶

Zhvillimi dinamik i sektorit privat në NMVM, me theks të veçantë sektori i prodhimit si dhe nismat për privatizim janë hapat e parë të proceseve drejt zhvillimit të ekonomisë së tregut dhe integritimeve në institucionet rajonale dhe ndërkombëtare. Në ekonominë e Kosovës ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme përbëjnë shtyllën kryesore të ekonomisë.⁷ Në vijim kemi paraqitur në grafik ndarjen e ndërmarrjeve në Kosovë sipas madhësisë.

Grafiku 1 Përqindja e ndërmarrjeve në Kosovë sipas madhësisë 2022⁸.



Nga Grafiku 1 shihet se si këto ndërmarrje përbëjnë tregun në Kosovë. Përqindjen më të madhe e përbëjnë ndërmarrjet mikro me 91.9%, ndërmarrjet e vogla 6.8%, ndërmarrjet e mesme me 0.2% dhe vetëm 0.7% janë ndërmarrje të mëdha.

Në Tabelën 1 është paraqitur kategorizimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në BE. Pothuajse në të njëjtën formë kategorizohen edhe ndërmarrjet në vendin tonë⁹, përveç se nuk ka kriter i cili i kategorizon ndërmarrjet nga të hyrat e tyre siç bëhet në vendet e BE-së, mirëpo vetëm me numrin e punëtorëve.¹⁰

5. EU small and medium-sized enterprises: an overview (<https://ec.europa.eu/eurostat/web/products-eurostat-news/-/edn-20220627-1>).

6. Small and medium-sized enterprises: an overview (<https://ec.europa.eu/eurostat/web/products-eurostat-news/-/ddn-20200514-1#:~:text=In%202017%2C%20there%20were%2022.2,for%2067%25%20of%20all%20employed>).

7. Raporti "Sektori C Industria Përpunuese" (fq. 8).

8. SME Policy Index: Western Balkans and Turkey 2022 (fq. 37).


9. Ligji Nr. 04/L-220 për Investimet e Huaja.

10. SMEs in Europe - Statistics & Facts (https://www.statista.com/topics/8231/smes-in-europe/#topicHeader__wrapper).

Tabela 1 Kategorizimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme sipas BE-së.¹¹

Kategorizimi i kompanive	Numri i të punësuarve	Qarkullimi vjetor (milion Euro)	Bilanci i gjendjes (milion Euro)
Ndërmarrje të mesme	<250	<=50	<=43
Ndërmarrje të vogla	<50	<=10	<=10
Mikro-ndërmarrje	<10	<=2	<=2

Në Ballkanin perëndimor ka një trend të rritjes të numrit të bizneseve, për më tepër, në raportin e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OBZhe)¹² ceket se ka një rritje të produktivitetit të NMVM-ve të rajonit që nga viti 2017. Edhe pse NMVM-të përbëjnë 72% të punësimit, ka të dhëna që numri i punësimit të punëtorëve është zvogëluar për 1.3% që nga viti 2017.¹³

Grafiku 2 Numri i NVM-ve për 1,000 banorë në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi (2017 dhe 2020)¹⁴.

Nga të dhënat në Grafikon 2 shihet se ka trend të rritjes së numrit të bizneseve në Ballkanin perëndimor përgjatë viteve 2017-2020 për rreth 13%, ndërsa në Kosovë ka një rritje rreth 18%.

Në Kosovë gjatë vitit 2020, NMVM-të ishin 42,881 dhe përbënin 99.84% të të gjitha ndërmarrjeve në ekonomi, duke shënuar rritje për 4,850 njësi që nga viti 2017. NMVM-të gjithashtu kanë rritur punësimin me rreth 27,000 persona në të njëjtën periudhë, duke zënë 75.5% të punësimit total në ekonomi të Kosovës. Numri i mikro-ndërmarrjeve ka rënë përafërsisht 1% që nga viti 2017 deri në 2020, që është absorbuar pjesërisht nga një rritje prej 0.63% në ndërmarrjet e vogla.¹⁵


11. Internal Market, Industry, Entrepreneurship and SMEs (https://single-market-economy.ec.europa.eu/smes/sme-definition_en).

12. SME Policy Index: Western Balkans and Turkey (WBT) 2022.

13. SME Policy Index: Western Balkans and Turkey 2022 (fq. 36).

14. SME Policy Index: Western Balkans and Turkey 2022 (fq. 36).

15. SME Policy Index: Western Balkans and Turkey 2022 (fq. 1064).

Grafiku 3 *Ndryshimi i të punësuarve në NMVM.*¹⁶

Në Grafikon 3 është paraqitur përqindja e ndryshimit të të punësuarve përgjatë viteve 2017-2020 në NMVM të cilat pësuan luhatje të mëdha. Për shembull, në ndërmarrjet mikro ka pasur ulje të punësimit për 2.3%, ndërsa në ndërmarrjet e vogla ka pasur rritje prej 2.3%, dhe në ndërmarrjet e mesme ka pasur ulje të punësimit për 0.3%.

16. SME Policy Index: Western Balkans and Turkey 2022 (fq. 557).

2 Objektiva dhe pyetjet e auditimit

Objektivë e këtij auditimi është vlerësimi i aktiviteteve të MINT-it/KIESA-së për arritjen e rezultateve të duhura në përkrahjen dhe ngritjen e kapaciteteve të NMVM-ve dhe Zonave Ekonomike. Përmes këtij auditimi synojmë që të japim rekomandime të cilat do të ndikojnë që në të ardhmen të përmirësohet pozita konkurruese e NMVM-ve dhe të ngritët cilësia e shërbimeve në Zona Ekonomike duke i ofruar kompanive vendosje më të shpejtë në ato zona.

Pyetjet e auditimit

Për të iu përgjigjur objektives së auditimit janë parashtruar pyetjet si në vijim:

1. A ka arritur MINT-i të planifikojë aktivitetet për përkrahjen dhe zhvillimin e NMVM-ve?
2. A është bërë analiza e nevojave për themelimin e ZE-ve dhe cilave biznese i është dhënë përparësi për t'u vendosur në ato zona?
3. A ka arritur MINT-i/KIESA që përmes koordinimit të tyre të sigurojë një proces të vlerësimit të drejtë për përfituesit?

Ky auditim ka përfshirë periudhën 2019-2022 të mbështetjes së NMVM-ve me grante për blerje të makinerisë, ndërsa për nevojat krahasuese lidhur me themelimin e ZE-ve ne kemi përfshirë vitin 2013. Pjesë e fushëveprimit të këtij auditimi ishin Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) dhe Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA). Në kuadër të MINT-it kanë qenë Departamenti i Industrisë dhe komisionet e vlerësimit të granteve nga MINT-i ndërsa në KIESA fokus i auditimit ka qenë Drejtorati për Zhvillimin e Sektorit Privat.

Metodologjia e detajuar e auditimit e aplikuar gjatë këtij auditimi, kriteret e auditimit dhe fushëveprimi i auditimit janë paraqitur në Shtojcën 1.

3 Gjetjet e auditimit

Misioni i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë është të kujdeset për krijimin e ambientit të favorshëm për zhvillimin e sektorit privat dhe bizneseve dhe avancimin e politikave për përkrahjen e industrisë, ndërmarrësisë dhe tregtisë, inovacionit dhe krijimin e kushteve të favorshme biznesore për tërheqjen e investimeve të huaja dhe investimeve strategjike¹⁷.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (tutje MINT) nga viti 2013 kishte Strategjinë për Zhvillimin e Sektorit Privat 2013-2017 e cila në fokus kishte përpjekjet për të rritur punësimin dhe për të reduktuar varfërinë, dhe krijimit të një sektori konkurrues në nivel global.¹⁸

Kjo strategji ishte e organizuar në tri shtylla:

- Zhvillimin, përkrahjen dhe promovimin e investimeve dhe bizneseve;
- Përmirësimin e Lëvizjes së Lirë të Mallrave apo rregullimin e Tregut të Brendshëm; dhe
- Avancimin e Politikave Tregtare.

MINT/KIESA përkrah bizneset në vend me forma të ndryshme siç janë: themelimi i zonave ekonomike (ZE)¹⁹, përkrahja e NMVM-ve me makineri, organizimi i panairove të ndryshme, etj.

Zonat Ekonomike

Qëllimi i krijimit të Zonave Ekonomike²⁰ është tërheqja e investimeve të huaja dhe vendore, përmirësimi i kushteve për zhvillim të bizneseve dhe ngritjes së standardit të jetesës për atë rajon si dhe krijimi i vendeve të punës. Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e Zonave Ekonomike në disa kategori:

17. Rregullore (zkm) nr. 03/2022 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e Vendeve të punës të ministrisë së industrisë, ndërmarrësisë dhe tregtisë

18. Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat 2013-2017.

19. Me Zonë Ekonomike kuptojmë një territor i ndarë, në përputhje me një plan të përgjithshëm, i pajisur me infrastrukturën e nevojshme, si rrugë, shërbime transporti dhe publike.

20. Aplikuesi duhet të arsyetojë themelimin e një zonë ekonomike në bazë të një studimi të fizibilitetit i cili përfshin: arsyeshmërisë ekonomike, fiskale, mjedisore, ligjore dhe administrative sipas të cilës rezulton se përfitimet ekonomike, fiskale dhe shoqërore që rrjedhin nga themelimi i zonës ekonomike tejkalojnë kostot e themelimit dhe të administrimit të saj dhe se themeluesi ka mjete financiare dhe kapacitete administrative të nevojshme për ndërtimin dhe administrimin e zonës ekonomike.

Tabela 2 Kategoritë e Zonave Ekonomike

Zonë e Lirë	Park Industrial	Park Teknologjik
• <u>Jo funksionale</u> • Mitrovicë • Gjakovë • Prizren • Zona e veçantë Amerikane	• <u>Funksionale</u> • Drenas • Suharekë (Shirokë) • Mitrovicë • <u>Jo funksionale</u> • Mitrovicë (Frashër) • Suharekë (Agro Zona) • Lipjan • Viti • Vushtrri • Rahovec	• <u>Funksionale</u> • Shtime

Në mars 2014, Qeveria, duke u bazuar në koncept-planin kombëtar për zhvillimin e ZE-ve në Kosovë 2014-2018, themeloi dy zona të lira ekonomike, një në Mitrovicë dhe një në Gjakovë.

Koncepti i Zonave të Lira Ekonomike nënkupton që këto zona janë të liruara nga tatimet doganore dhe kontrollet e ndryshme të importit, lirime të cilat sigurojnë një ambient atraktiv për investime, teknologji të avancuar, promovim të eksportit dhe rritje të numrit të të punësuarve.²¹

Park Industrial është një territor i ndarë, në përputhje me një plan të përgjithshëm, i pajisur me infrastrukturën e nevojshme, si rrugë, shërbime transporti dhe publike, me ose pa ndërtesa industriale, të ngritura paraprakisht, i destinuar për zhvillim industrial.²²

Park Teknologjik është një territor i ndarë sipas një plani të caktuar, i dizajnuar të akomodoj ndërmarrjet me shkallë të lartë teknologjike, zakonisht ka lidhje të ngushta me Universitetin dhe mund të jetë afër kompleksit Universitar.²³

Qëllimi i themelimit të këtyre zonave ishte tërheqja e investimeve të huaja dhe vendore, dhe ofrim të kushteve për zhvillim të biznesit. Në të njëjtin muaj, po ashtu me vendim të Qeverisë, është themeluar Zona e Lirë Ekonomike e Prizrenit, ndërsa në vitin 2018 Qeveria e Kosovës me vendim të kryeministrit ka themeluar Zonën e veçantë Amerikane.

Zonat e lira në Mitrovicë, Gjakovë, Prizren dhe zona e veçantë Amerikane ende nuk janë funksionale edhe përkundër që Qeveria ka marr vendim për themelimin e tyre.

MINT/KIESA themelon ZE-të në të cilat ka për obligim të ofroj kushtet për zhvillimin e veprimtarive siç janë: uji, rryma, rruga, trajtimi i ujërave të zeza, etj. MINT/KIESA ka licencuar dhjetë parqe industriale dhe teknologjike ndërsa ka arritur ti vë në funksion vetëm katër prej tyre.


21. Koncepti Plani Kombëtar Për Zhvillimin e Zonave Ekonomike në Kosovë 2014-2018.

22. Ligji Për Zonat Ekonomikë

23. Po aty.

Në vijim kemi paraqitur tabelën me buxhetin e ndarë nga Qeveria e Kosovës për ndërtimin e zonave ekonomike (Parqet Industriale dhe Parqet teknologjike) nga viti 2019-2022.

Grafiku 4 Shpenzimi i buxhetit në Zonat Ekonomike.



Më poshtë janë gjetjet që i kemi identifikuar gjatë auditimit të cilat janë rezultat i analizimit dhe vlerësimit të dokumentacionit, auditimit të proceseve, testimeve si dhe intervistave me zyrtarë përgjegjës në terren. Këto kanë shërbyer në dhënien e konkluzioneve të cilat janë paraqitur në Kapitullin 4 dhe rekomandimeve për përmirësimin e proceseve të cilat janë paraqitur në Kapitullin 5.

3.1 Mungesa e Strategjisë për Zhvillimin e NMVM-ve


Për të arritur një zhvillim MINT duhet të ketë një strategji kombëtare për zhvillimin e mjedisit të biznesit dhe zhvillimin industrial.²⁴ Qëllimi i strategjisë është të mbështesë zhvillimin e sektorit privat në Kosovë në mënyrë që të bëhet konkurrues në nivel rajonal dhe global²⁵. Po ashtu MINT-i duhet të ketë të zhvilluar analiza sektoriale për NMVM të cilat do t'i ndihmonin në planifikimin e përkrahjeve dhe zhvillimin e aktiviteteve për ngritjen e NMVM-ve.

Nga viti 2017, MINT nuk kishte strategji apo ndonjë program i cili do të orientonte industrinë dhe zhvillimin në vend. Një vit pas përfundimit të kësaj strategjie, në vitin 2018, MINT kishte filluar të hartonte Strategjinë për Zhvillimin e Sektorit Privat 2018-2022. Kjo strategji kishte për qëllim të përkrahte mjedisin e ndërmarrësisë dhe zhvillimit industrial dhe të përmirësoj skemat e përkrahjes dhe këshillëdhënës për NMVM-të.

Ndërsa MINT çdo vit përgatit raportin “Industria Përpunuese Sektori C - 2021” ne kemi analizuar të dhënat për të krahasuar investimet e huaja direkte në industrinë e prodhimit dhe industrinë e ndërtimit sipas sektorëve ekonomik gjatë viteve 2017-2021. Rezultatet tregojnë se investimet në industrinë e ndërtimit nga viti 2017 e tutje kanë qenë duke u ngritur me përjashtim vitin 2019. Ndërkaq, sa i përket industrisë së prodhimit investimet në këtë fushë janë në rënie.

24. SME Policy Index: Western Balkans and Turkey 2022.

25. Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021.

Grafiku 5 Investimet e huaja direkte në prodhim/ndërtim gjatë (milion euro).²⁶

Në mungesë të zhvillimit të politikave për përkrahjen e ndërmarrjeve prodhuese, në vendin tonë ka një rënie të investimeve siç shihet edhe në grafikun 4. Këtu janë të paraqitura investimet e huaja direkte në milion euro dhe përveç vitit 2019 i cili ka qenë pozitiv, në vitet 2020 dhe 2021 ka pasur një rënie të investimeve në prodhim dhe ngritje të investimeve në ndërtim.

Në mungesë të një strategjie aktuale dhe politikave zhvillimore për NMVM, MINT-i (përkatësisht Departamenti i Industrisë) ka zhvilluar aktivitete dhe studime të ndryshme. Ky departament ka punuar në zhvillimin e një udhërrëfyes për *klasterë* (rrjet i bizneseve që bashkëpunojnë për të qenë më konkurrues në treg, si dhe për rritjen e eksporteve) dhe ka hartuar studime²⁷ rreth sektorëve industrial siç është raporti vjetor “Industria Përpunuese Sektori C” (druri, tekstili, etj.).²⁸

MINT-i nuk ka zhvilluar ndonjë strategji të veçantë për NMVM dhe orientimin e NMVM-ve drejt transformimit të tyre dhe ngritjes së cilësisë dhe eksportit të produkteve të tyre drejt tregjeve të BE-së.

Edhe pse në MINT ka pasur përpjekje për të hartuar strategji për zhvillimin e sektorit privat këto përpjekje kanë dështuar dhe nuk është arritur të miratohet kjo strategji²⁹ Mungesa e një strategjie adekuate për një fushë aq kyçe siç është ajo e zhvillimit të sektorit privat dhe përkatësisht zhvillimi i NMVM-ve, rrezikon, përkrahjen dhe promovimin e investimeve dhe bizneseve, planifikim jo të duhur të aktiviteteve të ministrisë dhe menaxhim jo adekuat të resurseve publike. Në të njëjtën kohë në mungesë të strategjisë në KIESA kanë zhvilluar aktivitetet e tyre në bazë të planeve vjetore të tyre.

Sa i përket mbështetjes edhe më tutje MINT-i po vepron pa strategji dhe si pasojë edhe përkrahjet për NMVM-të në të ardhmen rrezikojnë të shkojnë në drejtim jo të duhur për shkak të mungesës së analizave të gjendjes reale dhe vizionit se cilat fusha janë me strategjikë për ngritjen e NMVM-ve.

26. Sektori C: Industria Përpunuese. 2021 (fq 10).

27. Sektori C: Industria Përpunuese.

28. Takim me Drejtorin e Departamentit të Industrisë, 23.11.2022.

29. Takim me Drejtore e Departamentit të Industrisë,

3.2 Zonat Ekonomike

3.2.1 Mos funksionimi i këshillit kombëtar për Zona Ekonomike

Qeveria e Republikës së Kosovës me propozim të Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë e emëron Këshillin Kombëtar për Zona Ekonomike.

Detyrat e këtij këshilli janë propozimi i politikave dhe hartimi i planit kombëtar për zhvillimin e zonave ekonomike tek MINT, këshillon investitorët me qëllim të lehtësimit të marrjes së vendimeve investive dhe vendosjen e tyre në zonat ekonomike³⁰

Qeveria e Kosovës me vendim në Prill 2013 ka emëruar Këshillin Kombëtar për Zona Ekonomike³¹. Këshilli kishte përgatitur në tetor të vitit 2013 “Koncept planin kombëtar për zhvillimin e zonave ekonomike në Kosovë 2014-2018” por nuk ishte i miratuar asnjëherë. Ky koncept plan parashihte zhvillimin e dy zonave të lira: Gjakovën dhe Mitrovicën. Për themelimin e këtyre dy ZE-ve në koncept plan kombëtar është bërë një përshkrim i shkurtër pa ndonjë analizë të detajuar e cila do të arsyetonte themelimin e këtyre dy zonave të lira ekonomike dhe pa një plan të arsyeshmerisë për themelimin e tyre.

Për të vënë në jetë këtë Koncept Plan ishte paraparë që të zhvillohet një plan i detajuar strategjik deri në mars të vitin 2014. Ne kemi kërkuar këtë plan por kemi kuptuar se ky dokument nuk ishte zhvilluar dhe ky këshill nuk ka mbajtur takime dhe nuk ka zhvilluar aktivitete siç parashihet në përshkrimin e detyrave të këtij këshilli.

Po ashtu pas këtij këshilli të parë i cili ishte themeluar në vitin 2013 nuk kemi gjetur se është themeluar një tjetër, po ashtu nuk kemi gjetur ndonjë dokument të cilin ka zhvilluar ky këshill përveç Koncept planit Kombëtar për zhvillimin e zonave ekonomike në Kosovë 2014-2018.

Mungesa e aktiviteteve të parapara që do t'i kryente ky këshill për ZE ka ndikuar që të mos zhvillohen planet kombëtare dhe planet e detajuara për zhvillimin e ZE-ve dhe ato zona të lira të cilat janë shpallur të mbesin vetëm në letër. Për më tepër, mungesa e këtij këshilli ka ndikuar që dhjetë ZE të cilat janë themeluar të bazohen vetëm në planin e fizibilitetit dhe jo në planin kombëtar për zhvillimin e ZE-ve siç edhe parashihet me ligj. Mos funksionimi i këtij këshilli ka ndikuar që të mos kryhen detyrat tjera siç janë: këshillimi i investitorëve për marrjen e vendimeve investive, vendosjen e tyre në ZE, nxitjen, mbështetjen dhe zhvillimin e ZE-ve, etj.

3.2.2 Themelimi i Zonave të lira ekonomike me vendime të qeverisë pa studim të fizibilitetit

Qeveria me vendim themelon zonat e lira në bazë të propozimit të Ministrisë dhe konsultimit me Doganat e Kosovës dhe komunën në territorin e së cilës parashikohet të themelohet zona e lirë. Zonat e lira që përfshijnë ose gjenden brenda territorit të një qyteti ose vendbanimi mund të mos rrethohen nëse Qeveria, pas konsultimit me Doganat e Kosovës, vlerëson se një gjë e tillë nuk e pengon administrimin e zonës së lirë si dhe zbatimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Republikës së Kosovës.

30. Për punët e këshillit për zona ekonomike.

31. Me kryesues nga MINT-i dhe anëtarë nga Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Asociacioni i Komunave të Kosovës, Oda Ekonomike Amerikane, Aleanca Kosovare e Biznesit, dhe Oda Ekonomike e Kosovës.

Në mars 2014 Qeveria, duke u bazuar në koncept planin kombëtar për zhvillimin e zonave ekonomike në Kosovë 2014-2018, themeloi dy zona të lira ekonomike të Mitrovicës dhe Gjakovës.

Qëllimi i themelimit të këtyre zonave ishte tërheqja e investimeve të huaja dhe vendore, dhe ofrim të kushteve për zhvillim të biznesit. Në të njëjtin muaj, po ashtu me vendim të Qeverisë, është themeluar Zona e Lirë Ekonomike e Prizrenit.

Në vitin 2018 me vendim të Qeverisë dhe sipas propozimit të grupit punues është themeluar Zona Ekonomike Amerikane (në Gjakovë) me sipërfaqe të parcelës prej 486.6 hektarë.

Sipas vendimeve, dy zonat e lira të themeluara sipas koncept planit kombëtar (në Gjakovë dhe Mitrovicë) si dhe dhe zona e lirë e Prizrenit ishin planifikuar të përfshinin të gjithë zonën kadastrale të atyre komunave.

Koncepti i Zonave të Lira Ekonomike nënkupton që këto zona janë të liruara nga tatimet doganore dhe kontrollet e ndryshme të importit, lirime të cilat sigurojnë një ambient atraktiv për investime, teknologji të avancuar, promovim të eksportit dhe rritje të numrit të të punësuarve.³²

Qeveria nuk ka arritur ti funksionalizojë zonat e lira në Mitrovicë, Gjakovë, Prizren dhe zonën e veçantë Amerikane edhe përkundër që ka marr vendim për themelimin e tyre. Mos funksionalizimi i këtyre zonave ka ndodhur si pasojë që Qeveria nuk i ka paraprirë me analizimin e nevojave dhe me hartimin e planit të fizibilitetit për të vlerësuar dhe argumentuar nëse ja vlen të themelohen këto zona. Ende nuk është ndërmarrë asnjë aktivitet për vënien në funksion të këtyre zonave. Po ashtu, nga Sektori për Zhvillimin e ZE-ve i cili merret me vlerësimin e kërkesave për themelimin e ZE-ve, gjatë auditimit kemi kuptuar se për themelimin e Zonave të lira të Mitrovicës, Gjakovës, Prizrenit, dhe ajo Amerikane nuk është bere ndonjë analize për arsyeshmerinë e themelimit të tyre dhe nuk janë ndjekur procedurat e kërkuara sipas ligjit në fuqi dhe UA³³-së.

Nga ana e Sektorit për Zhvillimin e ZE-ve në KIESA kemi kuptuar se shpallja e gjithë territorit të një komune si zonë të lirë ekonomike ishte një praktikë e gabuar ndër vite, kjo pasi që themelimi i kësaj zone nënkupton që këto komuna do të duhej të lirohen nga tatimet doganore dhe kontrollet e ndryshme të importit. Gjithashtu ne kemi konstatuar se vënia në funksion e Zonave të Lira është e pamundur për shkak të mungesës së planit të arsyeshmërisë së themelimit të tyre. Po ashtu këshilli kombëtar i cili kishte detyrë të parashihnte funksionimin e tyre, nuk ishte aktiv dhe nuk kishte arritur të zhvillonte ndonjë plan për operimin e zonave të lira ekonomike.

Rezultati i mungesës së analizave dhe zbatimit të duhur të zonave të lira ekonomike është se ato nuk janë bërë funksionale dhe mbeten vetëm në letër. Kjo ka rezultuar në humbjen e mundësive për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në këto fusha.

32. Koncepti i Planit Kombëtar Për Zhvillimin e Zonave Ekonomike në Kosovë 2014-2018.

33. Udhëzim Administrativ (MTI) Nr. 01_2014

3.2.3 Mungesa e investimeve në Zonat Ekonomike

Zonat Ekonomike themelohen për qellim të nxitjes së investimeve private në veprimtari prodhuese, të ndihmojnë në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik në Kosovë, veçanërisht në sektorin privat, hapjen e vendeve të reja të punës dhe krijimin e të ardhurave. Ministria jep pëlqimin për themelimin e zonës ekonomike nëse propozimi për themelimin e zonës ekonomike është në pajtim me planin nacional për zonat ekonomike dhe nëse ka studimi i fizibilitetit.³⁴

Kuvendi i Kosovës me ligjin për ZE të vitit 2009 dhe plotësim ndryshimin e vitit 2013 ka paraparë themelimin e ZE-ve me qëllim të ngritjes dhe inkurajimit të investimeve në Kosovë duke ofruar investitorëve infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive afariste.

Nga viti 2005 deri në kohën kur kemi zhvilluar auditimin, dhjetor 2022, janë të themeluara dhjetë (10) ZE prej të cilave vetëm katër funksionojnë.

Tabela 3 Zonat Ekonomike të themeluara.

Nr.	Emërtimi	Data e shpalljes Zonë Ekonomike	Fillimi i ndër- timit	Data e Planifikuar e përfundimit	Përfundimi i ndërtimit
1.	Parku i Biznesit Drenas	16.08.2010	2005	2007	2013
2.	Parku i Biznesit Mitro- vicë	17.10.2012	-	-	-
3.	Parku Teknologjik Shtime	03.12.2013	2014	2017	2017
4.	Parku Industriale në Mitrovicë	15.05.2014	2014	-	E pa përfunduar
5.	Zona Agro-Industriale Suharekë	04.09.2015	2015	2020	E pa përfunduar
6.	Parku Industrial Su- harekë	03.03.2017	2017	-	2021
7.	Parku Industrial Lipjan	18.05.2016	2016	2019	në proces
8.	Parku Industrial Viti	21.02.2017	2017	-	në proces
9.	Parku Industrial Vushtrri	25.04.2018	2018	2020	2021
10.	Parku Industrial Rahovec	27.01.2020	2022	-	në proces

Nga Tabela 3 shihet se ka një devijim prej datës së planifikimit të përfundimit të ndërtimit të zonave ekonomike nga ajo që ka ndodhur në realitet, po ashtu edhe Parku Industrial në Vushtrri edhe pse është i përfunduar ende nuk janë vendosur bizneset në këto zone për shkak të procedurave të ngadalësuara.

Për themelimin e këtyre zonave janë marrë parasysh Ligji për ZE dhe kriteret e UA35 nga MINT-i36 siç janë plani i arsyeshmërisë, kërkesa e komunës përkatëse, pëlqimet nga institucionet përkatëse, etj. MINT-i jep pëlqim për themelimin e ZE-ve nëse propozimi për themelimin është në pajtim me planin nacional për ZE dhe nëse studimi i fizibilitetit e arsyeton themelimin e saj.

34. Ligji për Zona Ekonomike (neni 4).

35. UA Nr. 01/2014

36. Ligji nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike

Këto dhjetë zona ekonomike janë themeluar duke u bazuar vetëm në planet e fizibilitetit të cilët i kanë zhvilluar, ndërsa në mungesë të planit nacional nga ana e këshillit kombëtar, këto ZE janë themeluar vetëm duke u bazuar në koncept planin i cili nuk ishte i miratuar. Për më tepër, në këtë koncept plan nuk ceken vendet në të cilat do të ndërtohen këto zona apo ndonjë studim për themelimin e tyre.

Deri më tani infrastruktura fizike ka përfunduar në pesë zona ekonomike: në Drenas, Mitrovicë – qytet, Shtime, Shirokë (Suhareke), Lumadh (Vushtrri). Ndërsa në fazën e investimit janë edhe tre zona tjera ekonomike: në Viti, Lipjan dhe Rahovec. Po ashtu kanë mbetur për të ardhmen Agrozona në Suharekë dhe ZE në Frashër (Mitrovicë).

Ne kemi marrë për mostër pesë ZE ku dy të paraqitura më poshtë janë funksionale.

- Parku Teknologjik – Shtime;
- Parku i Biznesit – Drenas.


Ndërsa tri ZE të paraqitura më poshtë nuk kanë arritur të vendosen bizneset në ato zona:

- Parku Industrial –Lipjan;
- Parku Industrial –Vushtrri;
- Zona Agro-Industriale – Suharekë.

Nga analiza e tyre kemi gjetur se ndërtimi në të gjitha zonat kishte zgjatur dukshëm më shumë sesa ishte planifikuar fillimisht.

Ne kemi analizuar shpenzimin e buxhetit për investime kapitale total për dhjetë ZE për vitet 2019-2022 krahasuar me buxhetin e planifikuar, dhe shihet se viti 2022 qëndron më dobët sa i përket investimeve në ZE ku kemi shpenzime prej 140,699 euro apo vetëm 8.3% të buxhetit të planifikuar.

Grafiku 6 Shpenzimi i buxhetit në Zonat Ekonomike (€).



Sipas grafikut 6, në vitin 2021 dhe 2022 ka pasur realizim më të vogël të investimeve në ZE edhe pse nevoja e bizneseve për hapësira në zona ekonomike ishte e lartë.

Në vitin 2021 ishin planifikuar investime në Parkun e Biznesit në Viti, Parkun e biznesit në

Lumadh (Vushtrri), Parkun e biznesit në Qylag (Lipjan), dhe parkun e biznesit në Shirokë (Suharekë). Sa i përket kontratave me komunat ato ishin nënshkruar në dhjetor të vitit 2020 në mënyrë që të fillohet ndërtimi i ZE-ve në fillim të vitit.

Tabela 4 Problemet në ndërtimin e parqeve të biznesit.

Parqet e Biznesit	Nënshkrimi	Arsyeje e mos vazhdimit të punimeve në ZE
Parku i Biznesit në Viti	29.12.2020	Problem me prone, kushtet atmosferike etj.
Parku i Biznesit në Vushtrri	24.12.2020	Përfundimi i punëve me 14.12.2021 por nuk ka mundur të behet pranimi teknik për shkak të mungesës së komisionit nga ana e MINT/KIESA.

Edhe pse marrëveshjet për realizimin e punëve ishin nënshkruar në fund të vitit 2020, punët kishin ngecje në realizimin për shkak të çështjeve administrative në MINT të paraqitura në tabelën 5.

Sa i përket investimeve në **parkun e biznesit në Viti** kontratat ishte nënshkruar në fund të vitit 2020 dhe për shkak të problemeve pronësore nuk ka mundur të përfundohen me kohë. Në qershor të vitit 2022 është nënshkruar aneks marrëveshja me komunën për vazhdimin e punimeve por kompania nuk ka filluar punimet për shkak të ngritjes së çmimeve të materialeve ndërtimore. Përkundër përpjekjeve të KIESA-së që punët në parkun e biznesit të përfundohen me kohë, operatori ekonomik përgjegjës për kryerjen e punëve nuk ka arritur të përfundoj punët sipas marrëveshjes edhe pse KIESA kishte dhënë vërejtje ndaj operatorit ekonomik.

Sa i përket parkut të **biznesit në Vushtrri**, MINT ka pranuar kërkesë për pranim teknik pas përfundimit të ndërtimit. Megjithatë, MINT në 2021 nuk kishte themeluar komisionin për pranimin teknik, duke shkaktuar vonesë prej më shumë se një viti në projekt pikërisht për shkak të mungesës së komisionit. Vlen të ceket se themelimi dhe ndërtimi nga ana e KIESA-s ka përfunduar ndërsa mbetet në përgjegjësi të komunës të vihet në funksion të bizneseve. Mos vënia në funksion e zonave ekonomike të cilat janë përfunduar shkakton që bizneset të cilat kanë nevojë për këto zona të mos kenë mundësi të investojnë për shkak të hapësirave të kufizuara.

Sa i përket investimeve për vitin 2022 ishin paraparë investime në Parkun e Biznesit në Viti, Parkun e Biznesit në Lumadh të Vushtrrisë dhe propozime të reja për ndërtimin e Zonave Ekonomike.

Me fillim të vitit 2022 tek UD drejtori i KIESA-së, janë dorëzuar kërkesat nga ana e sektorit për zona ekonomike, që të përfundohen ato projekte të cilat nuk janë përfunduar në vitin 2021.

Investimet në zonën ekonomike të Vitisë nuk kanë vazhduar dhe kompania e ka njoftuar MINT/KIESA së për shkak të ngritjes së çmimeve në tregun global nuk ka qenë e gatshme të vazhdoj punën.

Tabela 5 *Iniciativa nga sektori i ZE në KIESA dhe nënshkrimi i marrëveshjeve me komuna*

Parqet e Biznesit	Iniciativa nga Sektori i Zonave Ekonomike në KIESA	Nënshkrimi ndërmjet MINT/KIESA dhe komunat
Parku i biznesit Viti	01.02.2022	29.06.2022
Parku i biznesit Vushtrri	01.02.2022	10.06.2022
Parku i Biznesit Lipjan	01.02.2022	06.09.2022
Zona Ekonomike e Ra-hovecit	01.02.2022	07.09.2022
Parku industrial Mitrovicë	01.02.2022	Nuk ka marrëveshje

Në tabelën me lartë kemi paraqitur planifikimin e investimeve në Zona Ekonomike të lartë cekura iniciativa këto nga sektori i Zonave Ekonomike (i cili është brenda KIESA-së) të cilat kanë nisur në fillim të vitit 2022, ndërsa nënshkrimi i kontratave me komuna kishte marrë kohë. Për këtë çështje nuk kemi pranuar ndonjë arsye nga MINT/KIESA. Kjo kishte pasojë si në fillimin e aktivitetit të ndërtimit, por edhe në shpenzimin e buxhetit për vitin 2022 i cili ishte në nivel të ulët.

Prej momentit të fillimit të aktivitetit të ndërtimit deri në momentin e përfundimit të saj është një proces i stërzgatur nga ana e ministrisë. Zgjatja e ndërtimit arsyetohet për shkak të kufizimeve buxhetore, megjithatë ne kemi analizuar shpenzimet e buxhetit për tre vite dhe kemi gjetur se në vitin 2021 buxheti i shpenzuar ka qenë rreth 57,97%, ndërsa në vitin 2022 shpenzimet e buxhetit janë vetëm 8.30%.

Tabela 6 *Shpenzimi i buxhetit në Zonat Ekonomike.*

Viti	Buxheti (milion €)	Shpenzimi (milion €)	Shpenzimi si % e buxhetit
2019	2.97	2.17	73.14%
2020	1.15	1.15	99.7%
2021	1.16	0.68	57.97%
2022	1.7	0.14	8.30%

Nga tabela 6 shihet se gjatë vitit 2021 dhe 2022 ka pasur shfrytëzim të ulët të buxhetit, konkretisht në vitin 2021 nuk janë realizuar 42% e buxhetit të paraparë, ndërsa në vitin 2022, 92% e buxhetit. Shkaqe për shpenzim të ulët janë: në Viti mos mbajtja përgjegjës e operatorit nga MINT/KIESA për vonesat e punëve, ngritjes së çmimeve në tregun global, dhe në rastin e Vushtrrisë kishte vonesa në procesin e formimit të komisionit për pranim teknik të projektit të ndërtuar.

Sa i përket vonesave brenda MINT/KIESA nga momenti i inicimit të aktiviteteve nga sektori i Zonave Ekonomike deri në nënshkrimin e kontratave nga ana e drejtuesve, nuk kemi pranuar ndonjë arsyetim.

Mos investimi dhe përfundimi jo në kohë i projekteve për zhvillimin e Zonave Ekonomike ka ndikim drejtpërdrejt në biznese, të cilat përballen me mundësi të kufizuara rritjeje dhe hapësira për aktivitete biznesore. Këtë e konfirmojnë takimet që i kemi zhvilluar si ekip në zona ekonomike në vend dhe pyetësoni të cilin e kemi zhvilluar në këto zona, ku theksojnë se mungesa e hapësirave për rritjen e veprimtarisë së biznesit është një nga problemet kryesore.

3.2.3 Mungesa e infrastrukturës në Zonat Ekonomike

Ne kemi analizuar veprimtaritë e bizneseve në ZE funksionale dhe kemi paraqitur më poshtë në tabelë veprimtaritë dhe numrin e të punësuarve.

Tabela 7 Veprimtaritë dhe numri i punëtorëve në ZE.

Zona Ekonomike	Biznese prodhuese	Biznese tregtare	Numri i punëtorëve
Parku i Biznesit - Drenas	38	3	600
Parku i Biznesit - Mitrovicë	14	6	290
Parku Industrial Shirokë – Suharekë	41	7	1,200
Parku Teknologjik - Shtime	11	0	135

Nga tabela 7 e paraqitur me lartë shihet se shumica e veprimtarive në këto Zona janë prodhuese pastaj një pjesë e vogël është veprimtari shërbyese dhe tregtare, ndërsa sa i përket të punësuarve në këto ZE Parku Industrial në Shirokë ka numrin më të lartë të të punësuarve.

Në parkun e Biznesit në Drenas nga fillimi i vendosjes së bizneseve deri më tani janë nënshkruar 88 kontrata me biznese të ndryshme për shfrytëzimin e hapësirave për vendosjen në park. Ndërsa për arsyeje të mos përmbushjes së kontratave nga ana e bizneseve përfituese janë shkëputur 47 kontrata dhe janë përzgjedhur biznese tjera për vendosje aty. ZE-të tjera janë nën menaxhimin e komunave dhe ato e kanë për detyrë që t'i përcjellin bizneset të cilat nuk realizojnë aktivitetet e tyre sipas kontratës.

MINT në momentin e themelimit të këtyre zonave dhe ndërtimit të tyre ka për obligim që në ato zona ti plotësojë nevojat bazike siç janë: furnizimi me energji elektrike, ujë, trajtim të ujerave të zeza etj. Gjatë vizitave tek Parku i Biznesit në Drenas, Parku Industrial në Suharekë, dhe Parku Teknologjik në Shtime jemi takuar me përfaqësues të disa bizneseve që operojnë aty. Pas këtyre takimeve, ne u kemi dërguar përfaqësuesve të të gjitha bizneseve në ZE si në vijim një pyetësor³⁷ me pyetje mbi kushtet në ZE:

- Parku Industrial – Drenas
- Parku Industrial –Mitrovicë
- Parku Teknologjik – Shtime
- Parku Industrial – Shirokë, Suharekë

37. Pyetësoni gjendet në shtojcën 1.


Tabela 8 Përgjigjet nga përfaqësuesit e bizneseve në ZE të shërbimeve të ofruara.

Zona Ekonomike	Numri i përgjigjeve	Përqindja e përgjigjeve
Parku Industrial – Drenas	16	80%
Parku i Industrial – Mitrovicë	4	33%
Parku Teknologjik – Shtime	3	38%
Parku Industrial – Shirokë, Suharekë	14	29%

Nga 108 pyetësorë të dërguar, janë përgjigjur 37 ose 34% përfaqësues të bizneseve. Pyetësi përbëhet nga pyetje mbi përmbushjen e nevojave të bizneseve për furnizimin me ujë, energji elektrike, kanalizim, të infrastrukturës rrugore, të kështit të qirasë, dhe ndikimin e krizës ekonomike në biznesin e tyre. Pyetjet për ujin, rrymën, kanalizimin, dhe rrugën janë paraqitur me shkallë nga 1-10 ku përgjigja 1 nënkuptonte pakënaqësi të madhe, ndërsa përgjigja 10 nënkuptonte kënaqësi maksimale.

Grafiku në vijim paraqet përgjigjet e përfaqësuesve të 37 bizneseve në këto katër pyetje. Përgjigjet janë kategorizuar si në vijim:

- 1-3: të pakënaqur
- 4-6: neutral
- 7-10: të kënaqur


Grafiku 7 Rezultatet nga pyetësi sa i përket shërbimeve të ofruara

Nga Grafiku 7 shohim se bizneset në ZE janë të pakënaqur me furnizimin me ujë, ku rreth gjysma e bizneseve janë shprehur si të pakënaqur me këtë shërbim. Nga 29 përgjigje që shprehin pakënaqësi me furnizimin me ujin, 10 (mbi një e treta) prej tyre janë nga bizneset

ne Parkun e Biznesit në Drenas. Gjatë vizitës tonë në këtë Zonë Ekonomike, kemi vërejtur se shumë bizneseve ju mungonin kushtet elementare siç është furnizimi me ujë, ku për pasojë bizneset kishin hapur bunarët me te cilët zhvilloni aktivitetet e tyre.

Gjithashtu, dy pyetje kanë përfshirë këstin e qirasë që paguajnë bizneset në Zona Ekonomike; njëra për vlerën vjetore që paguhet, dhe tjetra mbi perceptimin e përfaqësuesve të bizneseve se a është ai kështu i lartë, i përballueshëm, apo i ulët.

Grafiku 8 Perceptimi i ratës së qirasë.



Grafiku 8 thekson se bizneset në Parkun e Biznesit në Drenas mendojnë se qiraja është shumë e lartë. Kësti i qirasë për parcelën e caktuar në Drenas është mbi 15,000 euro në vit në krahasim me Parkun Teknologjik në Shirokë (Suharekë) ku qiraja është më pak se 600 euro në vit dhe perceptohet si e përballueshme nga bizneset.

Grafiku 9 Efekti i krizës ekonomike.



Pasi që vitet e fushëveprimit kanë përfshirë pandeminë dhe krizën globale, kemi shtruar pyetje mbi efektin e krizës ekonomike në bizneset në Zonat Ekonomike. Nga bizneset e anketuara, 3% janë përgjigjur se kriza ka ndikuar pozitivisht në biznesin e tyre, 14% janë shprehur se nuk ka pasur ndikim, ndërsa 84% janë shprehur se kjo krizë ka ndikuar negativisht në zhvillimin e aktivitetit të tyre afarist.

Sipas reagimeve të marra nga ndërmarrjet e vendosura në këto zona përmes pyetësorit, ata kanë theksuar se mirëmbajtja dhe gjelbërimi i

këtyre zonave nuk është në nivelin e duhur.

Nevojën për zgjerim të hapësirave na kanë konfirmuar edhe vetë bizneset, por këtë e kemi verifikuar edhe nga vëzhgimet fizike sepse disa biznese kishin nevojë për zgjerimin e veprimtarisë së tyre për shkak se aktualisht hapësira në të cilën operojnë është e pamjaftueshme. Disa nga bizneset që kishin potencial për shtim të kapaciteteve prodhuese dhe rrjedhimisht edhe të eksportit nuk kishin mundësi të zgjerimit të biznesit si pasojë e mos menaxhimit adekuat të parcelave.

Po ashtu nga vëzhgimi fizik i Zonave Ekonomike kemi vërejtur se ka hapësira të lira, ku disa prej tyre ishin të mbuluara me mbeturina dhe të cilat do të mund të shfrytëzoheshin nga bizneset e tjera të cilët kishin nevojë për hapësirë shtesë. Për shkak të mos menaxhimit të duhur të ministrisë/komunave që bizneset të lirojnë hapësirat të cilat nuk i përmbahen kontratave dhe të cilat nuk po përdoren për qëllimin e synuar ose për të gjeneruar aktivitet ekonomik, disa biznese që kanë një potencial të fortë rritjeje dhe kërkojnë hapësirë shtesë nuk mund të zgjerohen. Organet përgjegjëse për menaxhimin e këtyre zonave ekonomike nuk po japin mundësinë e zgjerimit duke mos liruar hapësirat e papërdorura që janë kontraktuar më parë nga bizneset.

3.3 Mungesë e analizave për nevojat e NMVM

MINT duhet të zhvilloj analiza sektoriale për NMVM të cilat do ti ndihmonin në planifikimin e përkrahjeve dhe zhvillimin e aktiviteteve për ngritjen e NMVM.

MINT-i/KIESA që nga viti 2018 ka filluar procesin e mbështetjes së NMVM-ve me pajisje/makineri me qëllim që të ndryshoj bilancin eksport-import në vend. Nga analiza e thirrjeve të cilat MINT-i/KIESA ka bërë për NMVM-të shihet se KIESA i mbështet tri kategoritë (mikro, të vogla, dhe të mesme) me makineri, pavarësisht nga madhësia e tyre apo nga apo nevojave specifike të tyre.

Ne gjatë analizës së thirrjeve kemi gjetur se të gjitha kategoritë e NMVM-ve përkrahen në të njëjtën formë siç janë investime në makineri dhe nuk kemi një kategorizim të nevojave të ndërmarrjeve si shembull ndërmarrjet e mesme kanë nevoja të ndryshme dhe probleme të ndryshme për dallim nga ndërmarrjet mikro dhe ndërmarrjet e vogla.

Në MINT/KIESA nuk ka ndonjë analizë të nevojave për përkrahjen e NMVM-ve, këtë gjë e dëshmojnë edhe thirrjet të cilat bëhen për përkrahjen e NMVM-ve ku nuk ka thirrje të veçanta për nevoja të ndërmarrjeve të ndryshme por të gjitha përkrahen në të njëjtën formë. Mungesa e një analize bazuar në nevojat dhe kërkesat e ndërmarrjeve sipas grupeve, bënë që shpallja publike për përkrahje të ndërmarrjeve të përdor të njëjtat kritere në shpallje për të gjitha grupimet e ndërmarrjeve.

Kjo ka bërë që shumica e ndërmarrjeve të mbështeten me makineri për rritjen e kapaciteteve prodhuese. Kjo konfirmohet edhe nga u.d. i KIESA-s i cili e potencon se KIESA mbështet vetëm në udhëzim administrativ për thirrjet të cilat i zhvillon. Gjatë auditimit jemi takuar me përfaqësues të ndërmarrjeve të ndryshme dhe kemi hasur se nuk janë vetëm makineritë ato për të cilat kanë nevojë, por edhe certifikimet me standarde të ndryshme, akreditime, trajnime, etj.

Përkrahja e NMVM-ve në vend pa strategji apo analiza paraprake për nevojat e tyre ndikon që ndërmarrjet në vend pavarësisht nga madhësia dhe nevojat e tyre të përkrahen në të njëjtën formë dhe me të njëjta mjete, e cila nëse shihet në afat më të gjatë mund të mos jetë e qëlluar për ngritjen e prodhimit të bizneseve në vend.

3.3.2 Vonesa në thirrje publike

Në mënyrë që të arrihen objektivat për përkrahjen e NMVM-ve KIESA duhet që thirrjet ti organizoj në atë mënyrë që i gjithë procesi të përfundoj në fund të vitit.

Sektori për projekte në fushën e NMVM-ve në KIESA në planin e punës kishin planifikuar që thirrjet t'i fillonin në tre-mujorin e parë dhe t'i përfundojë i gjithë procesi i përkrahjes në tre-mujorin e fundit të çdo viti. Nga analiza e thirrjeve për vitet 2019-2022 kemi gjetur se edhe pse këto thirrje ishin iniciuar me kohë nga Drejtorati për Zhvillimin e Sektorit Privat, procesi për fillimin e këtij aktiviteti ishte bërë me vonesë.

Tabela 9 *Datat e shpalljeve për përkrahje të NMVM-ve.*

Vitet	Thirrja Publike	Shpallja e përfitueseve	Monitorimi në terren
2019	27.05.2019	06.08.2019	26.03.2021
2020	24.06.2020	01.09.2020	13.05.2022
2020 ³⁸	12.09.2020	24.11.2020	13.05.2022
2021	26.08.2021	02.12.2021	21.10.2022 ³⁹
2022	08.09.2022	nuk janë shpallur	-

Ne kemi analizuar datat e thirrjeve publike ku shihet se ka një trend të vonesave të thirrjeve për mbështetjen e NMVM-ve. Siç shihet në tabelën 10, të gjithë shpalljet e përfituesve janë bërë në gjysmën e dytë të vitit.

Ne kemi kërkuar përgjigje nga ana e KIESA-së se cila është arsyeja e këtyre vonesave në thirrje. Gjatë analizimit të korrespondencave të brendshme kemi konkluduar se iniciimi i kërkesave për publikim janë bërë me kohë nga departamenti i Zhvillimit të Sektorit Privat. Ndërsa shkaktar i këtyre vonesave ka qenë tentimi për ndryshimin e UA dhe kriterëve për thirrje.

Ne vitin 2020 janë realizuar dy thirrje publike. Thirrja e parë është realizuar sipas planit të punës ndërsa thirrja e dytë "Ndarja e mjeteve financiare nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transferove sipas thirrjes publike për subvencionim të NVM-ve me pronësi të grave ndërmarrëse" është publikuar në fund të vitit 2020. Arsyeja e publikimit në fund të vitit të kësaj thirrje kishte ndodhur për shkak se kjo thirrje nuk ka qenë e planifikuar nga KIESA por kjo ka ardhur si kërkesë nga Kuvendi i Kosovës.

Ndërsa për vitin 2021, sipas zyrtarëve të KIESA-s, vonesa ka ndodhur për shkak se thirrja e parë është anuluar. Pastaj, ka marrë kohë ndryshimi i kriterëve dhe mënyra e aplikimit ka kaluar nga forma fizike në atë elektronike përmes platformës ekosova⁴⁰. Megjithatë, ky arsyetim nuk është shumë i qëndrueshëm për shkak se thirrjet nuk kishin ndonjë dallim në kriteret nga vitet paraprake me rregulloren e njëjtë.

38. Thirrja për gra Ndërmarrëse .

39. Monitorimi i thirrjeve për vitin 2021 është bërë vetëm për makineri jo për kriteret tjera të cilat i ka paraparë MINT siç janë punësimi etj.

40. <https://ekosova.rks-gov.net>

Në vitin 2022 nga Drejtorati për Zhvillimin e Sektorit Privat përkatësisht Sektori i NMVM-ve është bërë kërkesa për përgatitje të thirrjes dhe publikimit. Vonesën e ka shkaktuar iniciimi i ndryshimit të UA-së, edhe pse MINT-i/KIESA ka bërë përpjekje për të ndryshuar UA-në, mirëpo Ministria e Financave nuk kishte aprovuar kërkesën e KIESA-së dhe për pasojë KIESA ka vazhduar të punojë me UA e vjetër. Sipas planit të punës thirrjet ishin planifikuar të fillonin në tre mujorin e parë, përderisa MINT/KIESA ka bërë thirrjen publike me vonesë siç e kemi paraqitur në tabelën 10.

Vonesa në thirrje publike për përkrahjen e NMVM ndikon që i gjithë procesi të përcillet me vonesa edhe në implementim, monitorim, etj. Nënshkrimi i kontratave me përfitues është bërë praktikë të bëhet gjatë periudhës së dimrit, gjë që e vështirëson zbatimin e saj deri në pranverë. E gjithë kjo ndikon që implementimi i projekteve të ketë vonesa dhe siç shihet nga pjesa e monitorimit përfituesit e vitit 2019 ishin monitoruar pas dy viteve. Po ashtu, në të njëjtën kohë rrezikon buxhetin e vitit të ardhshëm i cili në fakt duhet të përdoret për thirrje publike të atij viti, e jo për pagesën e përfituesve të vitit paraprak. Duke parë zhvillimin ekonomik të vendit dhe ndryshimet e nevojave të bizneseve, vonesat e tilla në thirrje për përkrahje dhe publikim të rezultateve, ndikojnë që bizneset të humbin konkurrencën me bizneset e rajonit dhe më gjerë.


3.3.3 Buxheti i pa shpenzuar për shkak të vonesave në thirrje

Çdo vit KIESA në planet vjetore të saj parasheh aktivitetet të cilat do t'i zhvilloj për përkrahjen dhe ngritjen e NMVM-ve. Përveç aktiviteteve, KIESA planifikon edhe buxhetin të cilin do ta shpenzoj për këto aktivitete dhe ky buxhet aprovohet nga MINT-i.

Nga analiza e ndarjes së buxhetit për thirrje dhe panaire për NMVM, vërehet se shpenzimet e buxhetit nga viti 2019 deri në vitin 2021 ishin në nivel të kënaqshëm për përkrahjen e NMVM-ve, ndërsa sa i përket vitit 2022 shpenzimet e buxhetit janë shumë të ulëta –rreth 24% dhe këto shpenzime janë bërë për përfituesit e thirrjes së vitit 2021. Sa i përket thirrjeve për vitin 2022, nuk janë shpenzuar as një euro për shkak të mos publikimit më kohë të përfituesve.

Për shkak të njoftimeve të vonuara për vitin 2022, rezultatet e përfituesve nuk ishin publikuar ende, pavarësisht pritshmërive që procesi i monitorimit do të duhej të kishte përfunduar në po të njëjtë vit.

Grafiku 10 Shpenzimet e buxhetit për grante dhe panaire përgjatë viteve 2019-2022.



Ne grafikun me lartë kemi paraqitur ndarjen buxhetore për investime në grante dhe panaire dhe buxhetin e shpenzuar për këto aktivitete. Sa i përket viteve nga 2019 deri 2021 shpenzimet e buxhetit për NMVM kanë qenë po thuajse në nivelin e planifikimit, përveç vitit 2022 që ka qenë me i ulëti për shkak të vonesave në thirrje dhe publikim të rezultateve nga ana e MINT-it/KIESA-së.

Shkak për këto shpenzime të ulëta të buxhetit në vitin 2022 janë thirrjet publike të cilat bëhen me vonesë siç janë tentimi për ndryshimin e UA-së⁴¹ dhe ndryshimin e kriterëve për aplikim të cilat kanë marrë kohë deri te aprovimi final i shpalljeve.

Shpenzimet e ulëta për të vitit 2022 për zhvillimin e NMVM-ve, po ashtu edhe vonesa në shpalljen e thirrjeve publike për mbështetjen e NMVM-ve, ndikon që KIESA të rrezikoj kryerjen rolit të saj për mbështetjen e ndërmarrjeve. Si pasojë e kësaj, zvogëlon mundësinë e ndërmarrjeve vendore të jenë më konkurruese si brenda vendit e po ashtu edhe ne rajon. Për më tepër, kjo kufizon ngritjen e eksportit në mënyrë që të zvogëloj bilancin negativ që ka eksporti kundrejt importit.

3.3.4 Mangësitë në procesin e vlerësimit të aplikueseve për grante

Me rastin e aplikimit, subjekti duhet t'i plotësoj disa kriterë të cilat i japin të drejtën e fitimit të subvencionit nga ana e KIESA-së, ku si dokumente duhet të jenë: certifikata e biznesit, certifikata e numrit fiskal, vërtetimi i tatimit në pronë, etj.⁴² Ndërsa si kriterë të cilat ndikojnë në përzgjedhjen e përfituesve do të jenë: rritja e investimeve në Republikën e Kosovës, rritja e prodhimit vendore, rritja e eksportit, promovimi i turizmit, zhvillimi i NMVM-ve, rritja e kapaciteteve konkurruese të NMVM-ve, dhe hapja e vendeve të reja të punës.⁴³

Gjatë auditimit janë analizuar 11 mostra të vitit 2019, 21 mostra të dy thirrjeve të cilat janë bërë në vitin 2020, dhe 12 mostra për vitin 2021, përzgjedhja e mostrave është bërë në mënyrë të rëndomtë. Ndërsa për vitin 2022 nuk kemi marrë mostra për shkak që MINT-i/KIESA deri në përfundimin e fazës së ekzekutimit të auditimit nuk ka arritur që të publikoj përfituesit.

MINT-i për vlerësimin e thirrjeve publike për mbështetjen e NMVM-ve formon komision i cili përbehet nga pesë zyrtar, tre anëtarë prej të cilëve janë anëtar të rregullt me mandat një-vjeçar, ndërsa dy anëtarët tjerë emërohen rast pas rasti, varësisht nga fusha dhe natyra e kërkesës.

Në vitin 2019, janë financuar 28 ndërmarrje të kategorizuara si në vijim:⁴⁴

- 18 ndërmarrje mikro
- 8 ndërmarrje të vogla
- 2 ndërmarrje të mesme.

41. Udhëzimi Administrativ (MTI) Nr. 01/2018 Për Ndarjen e Mjeteve Financiare nga Kategoria Ekonomike e Subvencioneve dhe Transfereve

42. Udhëzimi Administrativ (MTI) Nr. 01/2018 Për Ndarjen e Mjeteve Financiare nga Kategoria Ekonomike e Subvencioneve dhe Transfereve (neni 5).

43. Udhëzimi Administrativ (MTI) Nr. 01/2018 Për Ndarjen e Mjeteve Financiare nga Kategoria Ekonomike e Subvencioneve dhe Transfereve (neni 6).

44. Lista përfundimtare e përfituesve për subvencione "Ndarja e mjeteve financiare nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve sipas thirrjes publike për subvencionim me mjete financiare për NMVM" (2019).

Gjatë analizimit të mostrave kemi hasur vetëm në një parregullsi në procesin e vlerësimit. Nga mostrat e testuara kemi vërejtur se një nga dy përfituesit në kategorinë e ndërmarrjeve të mesme nuk kategorizohet si ndërmarrje e mesme sipas numrit të punonjësve. Ndërmarrja në fjalë kishte deklaruar në aplikacion 1,009 punonjës⁴⁵, numër ky që tejkalon limitin prej 249 punonjësve për t'u klasifikuar si ndërmarrje e mesme për mbi 300%. Kjo ndërmarrje ka përfituar 50,000 euro për blerje të makinerisë për një nga njësitë e saj, ndërsa pjesën tjetër prej 100 mijë euro kishte deklaruar që do ta mbulonte nga burimet e veta.

Komisioni vlerësues, në lidhje me këtë çështje, ka theksuar se vlerësimi i tyre është konform UA-së⁴⁶ në të cilin kategorizimi i ndërmarrjes nuk është kriter diskualifikues. Për përdorimin e UA-së si bazë për vlerësimin e tyre, komisioni vlerësues janë bazuar në vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm për emërimin e komisionit ku ceket se Komisioni Vlerësues është përgjegjës për shqyrtimin e dokumentacionit dhe përgatit raportin përfundimtar në pajtim me UA⁴⁷.

Përdorimi i UA-së si bazë për përzgjedhjen e përfituesve nuk arsyeton mos-bazimin në shpalljen publike pasi që në UA ceket se përveç kriterëve të parapara në UA, MINT-i mund të paraqesë edhe kritere shtesë në shpallje të cilat duhet të plotësohen.⁴⁸ Në vitin 2019 shpallja publike edhe pse nuk thekson si kriter diskualifikues të pasurit mbi 249 punonjës⁴⁹, ishte e drejtuar specifikisht për NMVM.

Ndarja e granteve për ndërmarrje të mëdha në vend të NMVM-ve për të cilat është ndarë buxheti rrezikon mos-arritjen e rezultateve të planifikuara të MINT-it dhe mos përfitimin e atyre që kanë plotësuar kriteret e të cilat kanë kapacitete më të vogla financiare për zhvillim.

3.4 Gjendja e bizneseve pas përfitimit

3.4.1 Monitorimi jo-adekuat i përfituesve nga MINT/KIESA

Përfituesi i subvencioneve dhe transfereve, pas realizimit të projektit është i obliguar të dorëzojë në Ministri një raport përshkrues financiar së bashku me faturat për shpenzimet e krijuara gjatë realizimit të projektit. Zyrtari apo komisioni monitorues i projektit pas pranimit të dokumentacionit nga përfituesi për përfundimin e projektit, e kontrollon atë nëse është realizuar apo jo projekti sipas marrëveshjes.⁵⁰ Për të vlerësuar efektivitetin e përkrahjes nga ana e MINT-it/KIESA-së duhet të ketë monitorim të vazhdueshëm i cili siguron informata për planifikimet e ardhshme.

MINT-i në vitin 2018 ka caktuar komisionin e monitorimit i cili kishte në përbërje tre zyrtarë. Këta zyrtarë kishin njohuri të ndryshme si teknologjike, ligjore dhe biznese/ekonomike. Përbërja e këtij komisioni në këtë mënyrë ishte bërë me qëllim që secili nga zyrtarët të vlerësonte zbatimin e projektit në anën ligjore, teknologjike dhe biznese.

MINT-i/KIESA pas shpalljes së përfituesve kishte nënshkruar marrëveshje me kompanitë përfituese në të cilën ceken disa obligime të cilat kompania përfituese duhet t'i përmbush

45. Aplikacion për pjesëmarrje të subvencionimit me mjete financiare për NMVM.

46. Udhëzimi Administrativ (MTI) Nr. 01/2018 Për Ndarjen e Mjeteve Financiare nga Kategoria Ekonomike e Subvencioneve dhe Transfereve.

47. Vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria e transfereve dhe subvencioneve për realizimin e projekteve (24.06.2019).

48. Udhëzimi Administrativ (MTI) Nr. 01/2018 Për Ndarjen e Mjeteve Financiare nga Kategoria Ekonomike e Subvencioneve dhe Transfereve (neni 4, pika 4).

49. Email nga Komisioni Vlerësues mbi shkakun e jepjes së grantit ndërmarrjes së madhe.

50. Udhëzimi Administrativ (MTI) Nr. 01/2018 Për Ndarjen e Mjeteve Financiare nga Kategoria Ekonomike e Subvencioneve dhe Transfereve (neni 15-16).

gjatë zbatimit të programit për një periudhë dyvjeçare pas nënshkrimit të marrëveshjes. Në marrëveshjet të cilat ka nënshkruar MINT-i/KIESA me kompanitë përfituese, përveç obligimeve tjera të përfituesit janë të obliguar të mbajnë edhe numrin e të punësuarave siç e kanë paraparë në plan të biznesit dhe kontratë. Në vijim po paraqesim obligimet⁵¹ e kompanisë përfituese si në vijim:

Pika 1. Duhet të punësoj numrin e punëtoreve të cilët ka deklaruar në aplikacion deri me datë të caktuar;

Pika 1.4 të dëshmojë me raport të ATK-së që ka punësuar numrin e punëtoreve të deklaruar në aplikacion deri me afat të përcaktuar në kontratë;

Pika 1.6 punësimin sipas deklarimit dhe vlerësimit të komisionit duhet të realizohet me se largu deri me datë të caktuar dhe të raportoj në MINT me raport të ATK-së.⁵²

Gjatë monitorimit të përfitueseve të thirrjes publike të vitit 2019, komisioni monitorues kishte konstatuar gjendjen në terren të cilën e kemi paraqitur në tabelën 12 me poshtë:

Tabela 10 Zbatimi i kontratës nga përfituesit

Viti	Totali i përfitueseve	Kanë zbatuar kontratën	Nuk e kanë zbatuar kontratën
2019	28	8	20
2020	24	13	11

Nga 28 përfitues në vitin 2019, vetëm 8 prej tyre kishin kryer të gjitha obligimet sipas kontratës, ndërsa 20 të tjerë nuk kishin realizuar punësimin sipas marrëveshjes. Përderisa, në vitin 2020 nga gjithsej 24 përfitueseve, 13 kanë kryer të gjitha obligimet ndërsa 11 të tjerë nuk i kanë përmbushur kriteret e punësimit sipas marrëveshjes së nënshkruar me KIESA-n.

Kompanitë përfituese në momentin e shpalljes si përfitues nënshkruajnë marrëveshjen me MINT-in/KIESA-në se do ta realizojnë projektin ashtu siç e kishin paraparë gjatë aplikimit dhe i transferohen mjetet për blerjen e makinerisë.

Edhe pse komisioni vlerësues kishte deklaruar se operatorët të caktuar nuk kanë plotësuar kriteret, MINT-i/KIESA në mungesë të ndonjë procesi për ndëshkim nuk ka ndërmarrë hapa për detyrimin e tyre për zbatimin e këtij kriteri.

Mos-përmbushja e këtij kriteri nga ana e kompanive paraqet problem sepse për çdo person që kompania kishte deklaruar në aplikacion se do ta punësonte, kishte përfituar nga 3 pikë gjatë aplikimit (ku maksimumi ishte 30 pikë për 10 të punësuar). Kjo ka ndikuar që këta të shpallen edhe përfitues kundrejt aplikuesve të tjerë, të cilët kishin paraqitur punësim më të vogël në krahasim me këto kompani të cilat kanë përfituar dhe nuk e kanë realizuar këtë kriter.

MINT-i/KIESA nga viti 2018 deri në vitin 2020 në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes me përfituesit kishte transferuar mjetet financiarë në llogari të përfitueseve në mënyrë që t'i mundësonte ta blinin makinerinë. Kjo ka ndryshuar në thirrjen e vitit 2021 pasi që MINT/KIESA kanë vendosur që në momentin e nënshkrimit me përfituesit të kompanive të transferohet vetëm gjysma e pagesës së përfituar ndërsa gjysma tjetër të transferohet në momentin kur kompanitë të dëshmon MINT-it/KIESA-së se ka blerë pajisjen dhe e ka vendosur në prodhim.

51. Kontrata me përfitues ndërmjet MINT/KIESA dhe përfituesit, Neni 5

52. Kontrata me përfitues.

Monitorimi i përfituesve për vitin 2021 ishte zhvilluar në vitin 2022 dhe vetëm për blerjen e makinerive nga ana e kompanive, në mënyrë që të transferohen mjetet tek përfituesit për shkak se i vetmi kriter për transferimin e mjeteve ka qenë blerja e makinerisë sipas kontratës ndërmjet MINT/KIESA dhe përfituesit⁵³. Sa i përket vlerësimit të kriterit të punësimit, komisioni ka paraparë edhe një monitorim tjetër gjatë vitit 2023.

Për thirrjen e vitit 2022, parashikohej të përfundonte shpallja e përfituesve dhe i gjithë procesi i thirrjes, përfshirë monitorimin në terren. Megjithatë, deri në fund të vitit 2022, shpallja e përfituesve ende nuk është bërë.

Në mënyrë që të vlerësojmë gjendjen sa më reale, dhe të paraqesim rezultatet sa më të sakta të mbështetjeve të cilat zhvillon MINT-i/KIESA, ne kemi kërkuar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) numrin e punëtorëve dhe të hyrat para përfitimit të mbështetjes dhe pas përfitimit të mbështetjes për mostrat e përzgjedhura. Në fakt këto të dhëna do të duhej t'i kishin KIESA por gjatë zhvillimit të auditimit është potencuar se MINT-i/KIESA nuk ka zhvilluar ndonjë aktivitet sa i përket mbledhjes së këtyre të dhënave. Nëse MINT-i/KIESA do të zhvillonte takime të rregullta me kompani përfituese do t'i ndihmonte që thirrjet në vitet në vazhdim t'i avancoj dhe ti bëjë në bazë të nevojave të NVMV-ve.

Në vijim ne kemi paraqitur të dhënat të cilat i kemi kërkuar nga ATK⁵⁴ dhe kemi analizuar procesin e punësimit të këtyre kompanive.

Tabela 11 Numri i të punësuarve i NMVM-ve përfituese para dhe pas fitimit të mbështetjes (2019).

Ndërmarrja	2018	Të deklaruar në aplikacion	Planifikimi i punësimit	Totali për vitin 2020	Totali për vitin 2021	Totali për vitin 2022
Mikro	0	2	10	11	11	11
Mikro	21	5	10	14	11	12
Mikro	1	1	10	10	11	1
E mesme	117	103	5	188	230	229
E mesme	1,481	1,009	10	1,306	576	564

53. Në raporte të përmblendhura 09.12.2022 15.09.2022 , 01.07.2022 dhe 20.10.2022

54. Deri me në muaj 10/2022

Tabela 12 Numri i të punësuarve i NMVM-ve përfituese para dhe pas fitimit të mbështetjes (2020).

Ndërmarrja	2019	Të deklaruar në aplikacion	Planifikimi i punësimit	Totali për vitin 2021	Totali për vitin 2022
Mikro	5	6	9	13	14
Mikro	1	3	5	5	5
Mikro	6	6	9	9	11
Mikro	0	1	4	5	6
Mikro	0	1	4	6	7
Mikro	3	7	15	12	11
E vogël	25	22	6	32	34
E vogël	28	18	9	23	16
E mesme	203	206	15	151	54
E mesme	59	52	15	78	79

Tabela 13 Numri i të punësuarve i NMVM-ve përfituese para dhe pas fitimit të mbështetjes (2021).

Ndërmarrja	2020	Të deklaruar në aplikacion 2021	Planifikimi i punësimit	Totali për vitin 2022
Mikro	3	2	4	4
Mikro	4	4	3	6
Mikro	4	2	4	4
E vogël	12	10	4	15
E vogël	15	14	5	-
E vogël	15	11	6	24
E mesme	172	82	21	96
E mesme	130	124	10	126

Burimi: Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) dhjetor, 2022.

Nga mostrat e përzgjedhura për kompanitë përfituese të viteve 2019-2021 shihet se vetëm 6 mikro-ndërmarrje, 2 të vogla, dhe 2 të mesme kanë respektuar marrëveshjet e tyre të punësimit, ndërsa 6 mikro-ndërmarrje, 3 të vogla dhe 4 të mesme nuk e kanë respektuar këtë kriter.

Këto të dhëna të cilat i kemi paraqitur më lartë nuk i posedon MINT-i/KIESA për gjendjen e kompanive përfituese dhe për mos-zbatimin e kritereve me anë të të cilave edhe i ka shpallur përfitues.


Këto të dhëna dhe të dhënat e plota për të gjitha kompanitë përfituese, janë thelbësore për MINT/KIESA sepse do të lejojnë organizatën të vlerësojë se si kompanitë përfituese po i zbatojnë kriteret dhe shkallën në të cilën ato po ndjekin kriteret e paracaktuara gjatë procesit të aplikimit.

3.4.2 Përkrahjet nuk kanë ndikuar në rritjen e të hyrave

MINT/KIESA përkrah ndërmarrjet të cilat gjatë aplikimit në projekt propozimin dëshmojnë se subvencionimi i ndarë do të ndikojë në: rritjen e investimeve në Republikën e Kosovës, rritjen e prodhimit vendore, rritjen e eksportit, promovimin e turizmit, zhvillimin e NVM-ve, rritjen e kapaciteteve konkurruese të NMVM-ve hapjen e vendeve të punës.


Në të njëjtën mënyrë kemi analizuar të hyrat e kompanive para përfundimit të mbështetjes nga ana e MINT-it/KIESA-së dhe pas mbështetjes dhe këto të dhëna i kemi paraqitur në dy grafiket me poshtë.

Grafiku 11 dhe 12 të hyrat e kompanive mikro dhe të vogla përfitues të vitit 2019



Në dy grafiket të paraqitura me lartë kemi paraqitur të dhënat për të hyrat e dy mikro kompanive, njëra nga këto kompani mikro në vitin 2018 kishte deklaruar të hyra mbi 2 milion ndërsa në vitin 2019 dhe tutje nuk kishte deklaruar fitim në ATK, ndërsa kompania tjetër mikro përveç vitit 2020 në të cilin kishte deklaruar fitim më të ulët vitin tjetër kjo kompani kishte rritur fitimin.

Ndërsa të dy kompanitë e vogla përfituese vetëm një vit pas përfundimit kanë pasur rritje të profitit ndërsa vitin pasues kanë pasur ulje të dukshme. Është e evidente se të gjitha këto kompani nuk kanë pasur afarizëm të mirë pas marrjes së mbështetjes nga MINT.

Grafiku 13 të hyrat e kompanive të mesme përfitues të vitit 2019



Në grafikun 13 janë paraqitur të hyrat e dy kompanive të klasifikuara si të mesme (edhe pse njëra nga këto kompani është kompani e madhe. Referohuni tek gjetja 3.4.1) përfituese të vitit 2019.

Nga grafiku shihet se dy kompanitë kanë pasur rënie të profitit gjatë viteve 2018-2020 dhe rritje në vitin 2021.

Në dy grafiket e paraqitura poshtë janë rezultatet e të hyrave të gjashtë kompanive të Mikro nga viti 2018 deri 2021. Këto kompani kanë përfituar mbështetje në vitin 2020 nga MINT/KIESA. Nga


grafiku shihet dukshëm se të gjitha kompani kanë pasur trend të rritjes.

Ndërkaq kompanitë e vogla përfituese të po të njëjtit vit dy nga këto nga viti 2020 kanë deklaruar që nuk kanë pasur fitim (kompanitë vogël 2 dhe vogël 4), ndërsa vetëm një kompani ka pasur rritje (kompania vogël 3) dhe tjetra (kompania vogël 1) ka pësuar zbritje pas përfitimit.

Grafiku 14 dhe 15 të hyrat e kompanive të mikro dhe të vogla përfitues të vitit 2020

Në grafikun 14 dhe 15 kemi paraqitur të dhënat për të hyrat e gjashtë mikro kompanive, dhe katër ndërmarrjeve të vogla përfituese të vitit 2020. Nga këto të dhëna shihet se kompanitë mikro kanë deklaruar të hyra më të larta pas përfitimit të mbështetjes ndërsa ndërmarrjet e vogla nuk kanë treguar sukses pas përfitimit nga MINT/KIESA.

Grafiku 16 paraqet rezultatet e të ardhurave të kompanive të mesme nga viti 2018 deri në vitin 2021 që kanë marrë mbështetje nga MINT/KIESA në vitin 2020. Një analizë e të dhënave nga përfituesit e MINT/KIESA 2020, të marra nga ATK, zbulon se ndërmarrjet kanë pasur të ardhura të ndryshme në vite të ndryshme.

Grafiku 16 të hyrat e kompanive të mesme përfitues të vitit 2020

Për sai përket thirrjeve për mbështetje të krijuara nga MINT/KIESA për të ndihmuar ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, nuk ka informacion të disponueshëm mbi efektivitetin e këtyre thirrjeve ose nëse ato duhet të rregullohen në bazë të madhësisë së bizneseve.

Ekipi i auditimit ka realizuar vizita në disa kompani të cilat kanë qenë përfituese dhe gjendja e tyre është paraqitur më poshtë.

3.4.3 Mungesa e monitorimit të vazhdueshëm nga MINT/KIESA

Gjatë vëzhgimit fizik janë vizituar pesë kompani përfituese dhe është vërejtur së të gjitha kanë në funksion makineritë të cilat i kanë përfitur, përveç një kompani e cila kishte problem me energjinë elektrike.

Nga vizita në terren tek përfituesit dhe takimeve me ndërmarrjet, vërehet një ndarje mes ndërmarrjeve të vogla dhe mikro dhe atyre të mesme. Ndërmarrjet mikro dhe të vogla janë në fazën e konsolidimit dhe rritjes së tyre dhe nevojat më të mëdha kanë qenë për makineri që do t'i mundësonte që të rrisin prodhimin dhe të zvogëlojnë kohën për prodhimin e produkteve. Ndërkaq, tek kompanitë e mesme, shumë prej të cilave edhe kanë arritur të mbulojnë tregun vendor me produkte, qëllimet dhe problemet e tyre kanë qenë rreth eksportimit të produkteve në vendet e BE-së. Disa nga problemet që kanë paraqitur janë nevoja për akreditim nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e cila nuk ka arritur të akreditohet për disa lloje të analizave, problemi me marrëveshjen e CEFTA-së e cila sipas bizneseve është shumë e pa favorshme për vendin tonë, dhe nevoja për më shumë ekspertë në mënyrë që ti perfeksionojnë produktet e tyre për të qenë me konkurruese në tregun ndërkombëtar dhe të trajnojnë stafin.

MINT/KIESA nuk ka zhvilluar mekanizma dhe procedura të përcjelljes në mënyrë të vazhdueshme të përfitueseve dhe për të siguruar që po i respektojnë kontratat të cilat kanë nënshkruar si përfitues, po ashtu edhe gjatë monitorimit të përfitueseve. MINT/KIESA nuk kishte ndërmarrë ndonjë hap i cili do të i detyronte kompanitë që të respektojnë këto kritere siç është numri i të punësuarëve.

Këto kritere MINT/KIESA duhet që ti analizoj dhe të përgatisë raporte për gjendjen në terren të NMVM-ve në mënyrë që thirrjet të cilat i zhvillon në të ardhmen ti bazojë në nevojat e ndërmarrjeve dhe jo vetëm duke u bazuar për nevoja të makinerisë.

Si shkak i mos monitorimit të vazhdueshëm të NMVM-ve nga ana e MINT/KIESA, kjo e fundit nuk i ka informacionet e nevojshme se në cilin drejtim duhet ti orientojë mbështetjen e NMVM-ve dhe nuk ka informacione se a duhet të ndahen thirrjet gjatë mbështetjeve të ndërmarrjeve mikro, të vogla, dhe të mesme.

Monitorimi vetëm në fillim i përfitueseve nga ana e MINT/KIESA paraqet rrezik se përfituesit nuk e zbatojnë kontratën në vazhdimësi për të cilën janë zotuar gjatë nënshkrimit të saj. Për më tepër, mungesa e monitorimit të vazhdueshëm i përfitueseve nga MINT/KIESA ka rezultuar në mungesë informacioni kthyes në lidhje me gjendjen e NMVM-ve dhe nevojat e tyre. Kjo do të thotë që informacioni nuk po përcillet në MINT/KIESA dhe programet e ardhshme mund të mos pasqyrojnë nevojat e ndryshme të ndërmarrjeve.

3.5 Mos koordinimi MINT/KIESA

Ministria dhe KIESA duhet të koordinohen për aktivitetet e hartimit të politikave dhe programeve përkrahëse për NMVM-të. Ministria duhet të analizoj dhe monitoroj zbatimin e politikave për zhvillimin industrial në Kosovë si dhe të programeve përkrahëse për NMVM-të nga KIESA. Ndërsa KIESA mbështet zbatimin e politikave dhe programeve publike në fushën e zhvillimit të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme dhe zhvillon politika lidhur me themelimin dhe zhvillimin e zonave ekonomike.

Në Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë është departamenti i industrisë i cili sipas përshkrimit të detyrave të punës duhet të udhëheq, koordinoj dhe monitoroj aktivitetet e hartimit të politikave me institucionet zbatuese, veçanërisht me KIESA, si dhe institucionet tjera politikë-bërëse.

Nga takimet të cilat kemi zhvilluar në departamentin e industrisë në MINT na është konfirmuar se departamenti i industrisë duhet ti kushtoj vëmendje koordinimit me KIESA-në. Që do të thotë se nuk kanë takime të rregullta për të diskutuar për politikat të cilat ekzistojnë, rishikimin e tyre, problemet dhe sfidat e bizneseve, si dhe adresimin e tyre. Po ashtu ky departament nuk ka arritur të bëjë monitorimin e zbatimit të politikave të saj. Më poshtë do i paraqesim disa aktivitete të këtij departamenti:

Në vitin 2017, MINT ka themeluar “Forumin për Zhvillim të Politikave Industriale”, i cili ka qenë në përbërje nga Ministrinë e Linjës që trajtojnë industrinë, Oda Ekonomike e Kosovës, OJQ, Shoqatat sektoriale të industrisë prodhuese, TIK-u, Fakulteti i Ekonomisë, KIESA dhe departamentet përkatëse në kuadër të MINT.

Po ashtu, në shtatë regjionet e Kosovës departamenti i industrisë mbanë një herë në vit takime të fokus grupeve, të përbëra nga anëtarë të Forumit, Drejtoritë komunale për ekonomi dhe bizneset prodhuese më të zhvilluara në atë regjion.

Qëllimi i këtyre takimeve është marrja e inputeve si dhe sfidat me të cilat ballafaqohet sektori privat, si dhe niveli komunal. Këto pastaj adresohen dhe filtrohen tek Forumi. Në të ardhmen parashihet bashkëpunimi ndërmjet MINT dhe KIESA në një program të reformave ekonomike (PRE) ku janë propozuar masa të përbashkëta.

MINT ka zhvilluar bashkëpunim dhe koordinim me KIESA sa i përket përgatitjes së projektligjit për parqet industriale dhe projektligjin për investime strategjike.

MINT në vitin 2019 kishte zhvilluar një vlerësim për përfituesit e projektit “Programi i KIESA-s për zhvillimin e NVM-ve 2017” ku me anë të një pyetësoi janë zhvilluar intervistat për të matur efektin e këtij programi, ndërsa pas këtij programi nuk kanë zhvilluar ndonjë monitorim me përfituesit e viteve tjera.

MINT konkretisht departamenti i industrisë nuk ka zhvilluar takime me KIESA në mënyrë që të merr informata se si janë duke u zbatuar politikat dhe thirrjet të cilat i organizon çdo vit, po ashtu edhe aktivitetet tjera. MINT nuk ka informata se cilat janë problemet që paraqiten në terren për zbatimin e këtyre politikave apo programeve të KIESA-s.

Për shkak të mungesës së koordinimit dhe monitorimit nga MINT të aktiviteteve të NMVM-ve, është e pasigurt nëse thirrjet e bëra kanë dhënë rezultatin e dëshiruar. Është gjithashtu e paqartë se çfarë veprimesh duhet të ndërmerren në të ardhmen në mënyrë që thirrjet e viteve tjera të jenë me të suksesshme.

Konkluzionet

MINT/KIESA nuk ka arritur rezultatet e duhura në përkrahjen dhe ngritjen e kapaciteteve të NMVM-ve dhe Zonave Ekonomike. Thirrjet nuk mbështeten në analiza për nevojat e NMVM-ve, po ashtu sistemi i thirrjeve, vlerësimi dhe monitorimi përcillet me mangësi të theksuara të cilat kanë nevojë për përmirësim. Për më tepër, zonat ekonomike të themeluara nuk arrijnë t'i përmbushin nevojat e ndërmarrjeve në vend duke i lënë investitorët të presin me vite për zgjerimin e hapësirave të biznesit dhe rritje të prodhimit dhe të punësimit.

1. MINT/KIESA nuk ka arritur të krijojë një strategji për rritjen e NMVM-ve po ashtu nuk ka zhvilluar analiza për gjendjen e këtyre ndërmarrjeve, të cilat konsiderohen si shtylla e ekonomisë globale. Edhe pse MINT kishte një strategji për zhvillimin e sektorit privat 2013-2017, MINT ka tentuar që të zhvilloj strategji të re pas kësaj periudhe, por kjo strategji nuk ishte aprovuar për shkak mungesës së trajtimit të çështjeve kryesore sa i përket zhvillimit ekonomik. Si rezultat, MINT/KIESA funksionon pa strategji dhe ka mungesë informacioni për gjendjen e NMVM-ve në vend.
2. Qeveria nuk ka arritur ti funksionalizojë Zonat e Lira Ekonomike edhe përkundër që i ka themeluar ato me vendim, kjo ka ndodh si pasojë e mos analizave paraprake dhe mos hartimit të planit të fizibilitetit. Këshilli kombëtar për Zona Ekonomike, përgjegjës për zhvillimin e Planit kombëtar Për ZE, përveç një koncept plani kombëtar për zhvillimin e ZE në Kosovë 2014-2018 nuk kishte zhvilluar dokumente tjera. Si rrjedhojë edhe ky koncept plan i cili ishte paraparë të aprovohej dhe të punohej sipas tij dhe të zhvillohet një plan i detajuar nuk është zhvilluar as një herë dhe as aprovuar. Këshilli nuk ka mbajtur as takime të rregullta dhe as nuk ka ndonjë dëshmi për funksionimin e tij, e ne mungesë të këtij këshilli kishin mbetur pa u kryer detyrat të cilat kanë qenë të paraparë për këtë këshill siç janë: planifikimi i zonave ekonomike në vend dhe vënien e tyre në funksion të investitorëve, këshillimin e investitorëve etj.
3. Çdo vit, MINT/KIESA shpall mbështetje për zhvillimin e NMVM në makineri. Ndonëse këto thirrje janë planifikuar të fillojnë në fillim të vitit dhe të përfundojnë në fund të vitit, procesi është i gjatë, duke bërë që thirrjet të publikohen me vonesë dhe të mos përfundojnë deri në fund të vitit. Këto vonesa ishin shkaktuar nga mos organizimi i brendshëm në lidhje me ndryshimin e legjislacion. Si pasojë e këtyre vonesave, KIESA nuk arrin të shpenzoj buxhetin të cilin e ka alokuar për mbështetjen e NMVM-ve. MINT/KIESA nuk kryen një analizë specifike të nevojave të NMVM-ve gjatë përgatitjes së thirrjeve të saj, dhe të gjitha thirrjet janë të fokusuara vetëm në makineritë mbështetëse. Nuk merret parasysh që biznese të ndryshme mund të kenë nevoja të ndryshme.
4. Komisioni nga MINT/KIESA nuk monitoron në mënyrë të vazhdueshme përfituesit të cilët marrin grante nga MINT/KIESA. Komisioni ka monitoruar thirrjet e vitit 2019 dhe thirrjet e vitit 2020 ndërsa thirrjet e vitit 2021 ka monitoruar vetëm për pjesën e makinerisë, ndërsa për pjesën e të punësuarave ka planifikuar një monitorim tjetër gjatë vitit 2023. Edhe pse komisioni monitorues kishte hasur në terren tek kompanitë përfituese se nuk i kishin zbatuar kriteret të cilat kishin paraparë në kontratë MINT/KIESA, nuk kishte ndërmarr ndonjë hap i cili do të detyronte përfituesit të zbatojnë kontratën dhe kushtet të cilat janë zotuar se do ti zbatojnë gjatë nënshkrimit të kontratës. Po ashtu MINT/KIESA nuk monitoron ndërmarrjet përfituese përgjatë viteve në mënyrë që të vlerësoj efektin e mbështetjeve të cilat i zhvillon çdo vit.
5. MINT dhe KIESA punojnë si dy institucione të ndara dhe nuk ka ndonjë koordinim ndërmjet tyre për thirrjet të cilat zhvillohen. departamenti i industrisë ka zhvilluar disa analiza dhe zhvillon takime me biznese. Këto takime organizohen në drejtoritë komunale me prodhues të regjioneve të vendit ku diskutohet mbi nevojat e bizneseve. pavarësisht kësaj MINT dhe KIESA nuk kanë një koordinim me të cilin do të arrinin që të i përdornin këto analiza në mënyrë që thirrjet të cilat i zhvillojnë në të ardhmen të bazohen në nevojat e bizneseve.

Rekomandimet

Me qëllim që të krijohet një sistem të i cili do të ndihmonte ngritjen e Ndërmarrjeve Mikro të Vogla dhe të Mesme dhe Zhvillimin e Zonave Ekonomike duhet me prioritet të zbatohen rekomandimet në vijim: Rekomandim për Qeverinë:

1. Të shfuqizohen vendimet për themelimin e Zonave të lira Ekonomike të cilat janë bërë në mungesë të analizave dhe pa studim fizibilitetit me të cilën do të argumentonin krijimin e tyre.

Rekomandim për MINT:

2. MINT duhet të zhvilloj analiza për nevojat e NMVM-ve dhe të zhvilloj strategji për mënyrën e ngritjes së këtyre ndërmarrjeve, në mënyrë që këto ndërmarrje të jenë me konkurruese në nivel vendor dhe ndërkombëtar.
3. Zhvillimi i thirrjeve për mbështetjen e NMVM duhet të behet duke u mbështetur në strategji dhe në analizat të cilat tregojnë nevojat reale të NMVM-ve.
4. Krijimi i Zonave Ekonomike duhet të ndjekë një proces të plotë, duke përfshirë planifikimin dhe buxhetimin afatgjatë. Procedurat e ndërtimit për këto zona duhet të nisin në fillim të vitit për të parandaluar humbjen e fondeve të ndara dhe për të plotësuar kërkesën për hapësirë në zonat ekonomike nga bizneset
5. Të gjitha thirrjet për përkrahjen e NMVM-ve të zhvillohen duke u bazuar në analiza për nevojat e NMVM dhe strategji të zhvilluar nga MINT. MINT/KIESA të sigurohen se thirrjet publike të zhvillohen në fillim të vitit.
6. MINT/KIESA duhet të ndërmarrë veprime për zbatimin e monitorimit të vazhdueshëm të ndërmarrjeve përfituese për të vlerësuar progresin e tyre në përmbushjen e kritereve të grantit. T'i mbajë ndërmarrjet përgjegjëse për mosplotësimin e kritereve të premtuara apo duke gjetur mënyre për kthimin e mjeteve me të cilat janë përkrahur.
7. Të koordinohen aktivitetet ndërmjet MINT dhe KIESA në mënyrë që politikat të cilat zhvillohen në të ardhmen të jenë në harmoni me nevojat e NMVM-ve po ashtu edhe për funksionimin e zbatimit të politikave të merren informata kthyes nga MINT.
8. Departamenti i industrisë të bëjë monitorimin e politikave të saj dhe të vlerësoj se cilat po arrijnë të zbatohen dhe cilat probleme po paraqiten gjatë zbatimit të tyre.

Shtojca I Kriteret, fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Motivi i Auditimit

NMVM-të luajnë rol kryesor sa i përket performancës ekonomike, qëndrueshmërisë dhe zhvillimit ekonomik të një vendi. NMVM-të në Ballkanin perëndimor dhe Turqi përbëjnë pothuajse tre të katërtat e punësimit në sektorin privat dhe gjenerojnë rreth 60% të vlerës së shtuar në sektorin privat⁵⁵.

Ndërkaq, në ekonominë tonë NMVM-të përbëjnë shumicën dërrmuese të totalit të ndërmarrjeve (99.8% në 2020) dhe punësimit total (80.4% në vitin 2020, dukshëm mbi mesataren e BE-së prej 65%⁵⁶). Si në të gjithë botën po ashtu edhe në vendin tonë NMVM-të u goditën rëndë nga kriza e COVID-19, e cila ndikoi negativisht në likuiditetin e tyre, pastaj me rritjen e fundit të inflacionit dhe kostove të energjisë si pasojë e pushtimit të Ukrainës rrezikon rimëkëmbjen e NMVM-ve.⁵⁷

Sektori i NMVM-ve në vend ende nuk ka arritur nivelin konkurrues si në nivelin kombëtar po ashtu edhe në nivelin ndërkombëtar. Ky sektor dominohet nga shitja me pakicë, dhe ende nuk ka arritur që të bëhet motor i rritjes ekonomike dhe të zëvendësoj importin dhe të angazhohet në vlerë më të lartë të shtuar. Shumica e NMVM-ve në Kosovë, veçanërisht ato në sektorin prodhues, nuk arrijnë që t'i përmbushin standardet e cilësisë, për shkak të kostos së investimeve të nevojshme për arritjen e tyre.⁵⁸

Sa i përket zhvillimit të NMVM në vendin tonë MINT dhe KIESA janë akteret kryesor të cilët merren me ngritjen dhe zhvillimin e tyre, por nga takimet të cilat kemi zhvilluar në këto entitete ka indikacione se mungojnë analiza lidhur me gjendjen e NMVM. Po ashtu ka mungesë të monitorimit të përkrahjes së ndërmarrjeve të cilat i mbështet me fonde publike dhe nuk ka ndonjë program i cili orienton Zhvillimin e NMVM.

Po ashtu në MINT/KIESA mungon databaza e cila do ti kategorizonte NMVM-të dhe ndarjen e tyre në sektor dhe orientonte MINT dhe KIESA-ën që të planifikonte me mire për zhvillimin e NMVM.

Gjithashtu, shpenzimet e ulëta publike për kërkim dhe zhvillim (vetëm 0.1% të BPV-së) si dhe mungesa e një infrastrukture koherente të inovacionit e dëmton zhvillimin e NMVM-ve.⁵⁹ Sa i përket mbështetjes së NMVM-ve, institucionet në vendin tonë mbështesin NMVM-të në mënyra të ndryshme duke filluar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e cila jep grante dhe subvencione për fermerë dhe për biznese të cilat kanë veprimtari zhvillimin e bujqësisë, ndërsa MINT-i përmes KIESA-së mbështet ndërmarrjet në mënyra të ndryshme siç janë: investime, eksport, turizëm, dhe Zonat e Veçanta Ekonomike.

Sipas Raportit të Progresit, riorganizimi strukturor i KIESA-së, që synon të mbështesë sektorin privat dhe të tërheqë investime, është shumë prapa planifikimit. Mungesa e një politike koherente për zhvillimin e industrisë në të gjithë zinxhirin e furnizimit minon konkurrencën e NMVM-ve.⁶⁰

55. SME Policy Index: Western Balkans and Turkey 2022 (fq. 5).

56. SME Policy Index: Western Balkans and Turkey 2022 (fq. 571).

57. SME Policy Index: Western Balkans and Turkey 2022 (30).

58. Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (fq. 33).

59. Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021.

60. Raporti i Progresit 2020 (fq. 45).

Numri i përgjithshëm i bizneseve të reja në vitin 2020 ishte 9,805, që shënon një rënie prej 2% krahasuar me vitin 2019. Numri i bizneseve të mbyllura në vitin 2020 ishte 1,326, një rënie prej 25% krahasuar me të njëjtën periudhë një vit më parë. Hendeku ishte veçanërisht i madh në tremujorin e dytë kur Kosova kishte një bllokim si pasojë e COVID 19.⁶¹ Ndërsa viti 2021 numri i përgjithshëm i bizneseve të reja ishte për 8.7% me e lart nëse e krahasojmë me vitin 2020, ndërsa numri i bizneseve të mbyllura për vitin 2021 ishte ngritur për 19% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të 2020.⁶²

Në bazë të hulumtimeve kemi identifikuar probleme në fazën e planifikimit, koordinimit, dhe monitorimit të aktiviteteve për NMVM-të në vendin tonë nga MINT-i dhe KIESA.

Kriteret e Auditimit

Kriteret e auditimit kanë rrjedhur nga ligji nr. 04/l-159 për zonat ekonomike, ligji nr. 04/l-220 për investime huaja, udhëzimin administrativ nr. 01/2018 për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve, marrëveshjet me përfitues, Planet vjetore të KIESA, Rregullore për punën e këshillit për Zonat Ekonomike.

Ministria duhet të ketë një strategji kombëtare për zhvillimin e mjedisit të biznesit dhe zhvillimin industrial.⁶³ Qëllimi i strategjisë është të mbështesë zhvillimin e sektorit privat në Kosovë në mënyrë që të bëhet konkurrues në nivel rajonal dhe global.⁶⁴ Po ashtu MINT duhet të ketë të zhvilluar analiza sektoriale për NMVM të cilat do ti ndihmonin në planifikimin e përkrahjeve dhe zhvillimin e aktiviteteve për ngritjen e NMVM.

Ministria, në konsultim me komunat, Doganat e Kosovës dhe grupet e interesit, përgatitë planin kombëtar për zhvillimin e zonave ekonomike në Kosovë, i cili përfshinë të gjitha zonat ekonomike komunale dhe qendrore që planifikohen të ndërtohen.⁶⁵

Këshilli Kombëtar për Zona Ekonomike duke qene trup koordinues, ka për detyrë të hartoj Planin Kombëtar për zhvillimin e Z.E. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MINT⁶⁶) në bashkëpunim me institucionet tjera relevante, përmes Agjencisë për Mbështetje të NMVM-ve, janë institucione përgjegjëse për implementimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin e Zonave Ekonomike në Kosovë dhe do të përkrahen nga ministritë relevante, komunat relevante, asociacionet e bizneseve dhe donatorët.

Zonat Ekonomike themelohen për qellim të nxitjes së investimeve private në veprimtari prodhuese, të ndihmojnë në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik në Kosovë, veçanërisht në sektorin privat, hapjen e vendeve të reja të punës dhe krijimin e të ardhurave etj.⁶⁷

Me rastin e aplikimit, subjekti duhet ti plotësoj disa kriteret të cilat i japin të drejtë të fitimit të subvencionit nga ana e KIESA-s, ku si dokumente duhet të jenë: certifikata e biznesit,

61. Raporti i Progresit 2021 (fq. 55).

62. Raporti i progresit 2022 (fq. 65).

63. SME Policy Index: Western Balkans and Turkey 2022.

64. Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021.

65. Ligji për Zona Ekonomike (neni 8).

66. Plan Kombëtar për Zhvillimin e Zonave Ekonomike (fq. 3).

67. Ligji për Zona Ekonomike (neni 4).

certifikata e numrit fiskal, vërtetimi i tatimit në pronë etj.⁶⁸ Ndërsa si kritere të cilat ndikojnë në përzgjedhjen e përfituesve do të jenë: rritja e investimeve në Republikën e Kosovës, rritja e prodhimit të vendore, rritja e eksportit, promovimi i turizmit, zhvillimi i NVM-ve, rritja e kapaciteteve konkurruese të NVM-ve, dhe hapja e vendeve të reja të punës.⁶⁹

Zyrtari ose komisioni monitorues kanë për obligim të përgatisin raport përmbledhës për realizimin e projektit. Përfituesi i subvencioneve dhe transfereve, pas realizimit të projektit është i obliguar të dorëzojë në Ministri një raport përshkrues financiar së bashku me faturat për shpenzimet e krijuara gjatë realizimit të projektit. Zyrtari apo komisioni monitorues i projektit pas pranimit të dokumentacionit nga përfituesi për përfundimin e projektit, e kontrollojnë atë nëse është realizuar apo jo projekti sipas marrëveshjes.⁷⁰ Për të vlerësuar efektivitetin e përkrahjes nga ana e Ministrisë/KIESA-së duhet të ketë monitorim të vazhdueshëm i cili siguron informata për planifikimet e ardhshme.

Ministria dhe KIESA duhet të koordinohen për aktivitetet e hartimit të politikave dhe programeve përkrahëse për NMVM-të. Ministria duhet të analizojë dhe monitorojë zbatimin e politikave për zhvillimin industrial në Kosovë si dhe të programeve përkrahëse për NMVM-të nga KIESA. Ndërsa KIESA mbështet zbatimin e politikave dhe programeve publike në fushën e zhvillimit të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme dhe zhvillon politika lidhur me themelimin dhe zhvillimin e zonave ekonomike.

Fushëveprimi i auditimit

Pjesë e fushëveprimit të këtij auditimi janë Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) dhe Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA). Në kuadër të MINT-it do të jetë Departamenti i Industrisë dhe komisionet e vlerësimit të granteve nga Ministria ndërsa në KIESA do të jetë fokus i auditimit Drejtorati për Zhvillimin e Sektorit Privat. Fushëveprimi do të fokusohet përgjatë viteve 2019 deri 2022 ndërsa për nevoja të krahasimit të ndërtimit të zonave ekonomike ne kemi zgjeruar auditimin nga viti 2013.

Metodologjia e auditimit

Për t'iu përgjigjur pyetjeve të auditimit, ekipi i auditimit do të kryejnë disa aktivitete në institucionet përgjegjëse duke përdorur një sërë teknikash audituese:

- Analizimin e kornizës ligjore dhe rregullatorë të MINT-it;
- Analizimin e kornizës ligjore dhe rregullatorë të KIESA-së;
- Intervistimin e personave përgjegjës dhe strukturat udhëheqëse të institucioneve përgjegjëse;
- Planet e MINT-it lidhur me themelimin e Zonave Ekonomike;
- Planet vjetore të departamenteve përkatëse në KIESA dhe MINT;


68. Udhëzimi Administrativ (MTI) Nr. 01/2018 Për Ndarjen e Mjeteve Financiare nga Kategoria Ekonomike e Subvencioneve dhe Transfereve (neni 5).

69. Udhëzimi Administrativ (MTI) Nr. 01/2018 Për Ndarjen e Mjeteve Financiare nga Kategoria Ekonomike e Subvencioneve dhe Transfereve (neni 6).

70. Udhëzimi Administrativ (MTI) Nr. 01/2018 Për Ndarjen e Mjeteve Financiare nga Kategoria Ekonomike e Subvencioneve dhe Transfereve (neni 15-16).

- Thirrjet publike për përkrahjen e NMVM-ve;
- Analizat sektoriale të cilat janë zhvilluar nga MINT për NMVM-të;
- Raportet mbi gjendjen e NMVM në Kosovë;
- Listat e aplikuesve/përfituesve për përkrahje nga KIESA/MINT-i;
- Raportet e monitorimit të terrenit për NMVM-të përfituese të granteve;
- Analizat e departamenteve lidhur me NMVM-të;
- Vizita në terren tek kompanitë përfituese për të shikuar nëse kompanitë janë ende në aktivitetin për të cilin kanë përfitur; dhe

Të dhënat e relevante nga të kompanive përfituese nga MINT të cilat do të merren nga ATK për të verifikuar gjendjen e kompanive në fjalë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës “Mbështetja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nga MINT/KIESA”, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: Prishtinë
19.04.2023

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:



- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit “Mbështetja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nga MINT/KIESA” (në tekstin e mëtejme “Raporti”), gjersa ri përsërisim kërkesën që auditimi i performancës të vazhdojë edhe për aktivitetet e drejtoratit për promovimin e sektorit privat, që funksionon brenda Agjencisë KIESA, që mes tjerash përfshijnë investimet strategjike, e po ashtu edhe mbështetjen e NVM-ve në aktivitete ndërkombëtare.
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Ministri



Përfituesit e makinerive nga KIESA





Zyra Kombëtare e Auditimit | Lagjja Arbëria | Rr. Ahmet Krasniqi, 210 | 10000 Prishtina

Republika e Kosovës